
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 18.04.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE UNIFORMA PËR POLICINË E BURGJEVE” e
ndarë në 2 (dy) lote:**

LOTI I: BLERJE UNIFORMA DHE GRADA PËR POLICINË E BURGJEVE

LOTIN II: BLERJE KËPUCË PËR POLICINË E BURGJEVE

**MARRËVESHJE KUADËR ME DISA OPERATORË EKONOMIKË KU TË GJITHA
KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA, ME NJË OPERATOR EKONOMIK PËR
SECILIN LOT.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP):

35811200-4 Uniforma Policie

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL TË MARRËVESHJES KUADËR: 1,390,769,925 (një miliard e treqind e nëntëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH dhe 14,055,280 (katërmëdhjetë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë) Euro pa TVSH.

Vlera e fondit limit total për Lotin I: “Blerje uniforma dhe grada për Policinë e Burgjeve” është 1,196,890,675 (një miliard e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë million e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH dhe 12,095,914 (dymbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë) Euro pa TVSH.

Vlera e fondit limit total për Lotin II: “Blerje këpucë për Policinë e Burgjeve” është 193,879,250 (njëqind e nëntëdhjetë e tre million e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 1,959,366 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 18.04.2025, me kurs këmbimi 98.95 (nëntëdhjetë e tetë pike nëntëdhjetë e pesë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara sh.a, në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI I: BLERJE UNIFORMA DHE GRADA PËR POLICINË E BURGJEVE

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 76 dhe Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar si dhe Neni 25, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit 1**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave

specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 1 është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 1 me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018

“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit⁴⁵. Nëse kërkojnë bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

Në nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në

atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 1.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të

mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:*

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit 1. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 84 (tetëdhjetë e katër) persona të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b.** Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shenim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më sipër do të pa raqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”* dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”.* Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”*

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Specifikimet teknike për artikujt objekt prokurimi, janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi *“Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”,* të ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr. 260 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”,* i ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.

Nisuar nga sasia, vlera e fondit limit të këtij loti, e cila është një vlerë e konsiderueshme, specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi kërkohet që operatori ekonomik të provojë se ka punonjës minimalish 84 për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për 3 muajt e fundit data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim minimalisht 84 punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik të kërkuar në kriterin nr. 3, që janë specialistë që do të merren drejtpërdrejt me prodhimin e produktit përfundimtar, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e prodhimit të mallrave objekt prokurimi.

Përcaktimi i këtij numri minimal punonjësish për kryerjen e kontratës objekt prokurimi është vendosur në mbështetje të pikës 1 të Nenit 3 të ligjit nr. 162 / 2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale”*. Pra ky kriter është vendosur në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh vëllimin e mallit, afatet kohore të kontratës dhe nevojat specifike të institucionit për marrjen në dorëzim të uniformave në mënyrë të standartizuar dhe pa vonesa.

Në kaudër të procesit për furnizimin me uniforma të Policisë së Burgjeve kërkesa për një numër punonjësish minimalisht prej 84 është një kërkesë e arsyeshme dhe proporcionale për të garantuar kapacitetin operativ dhe logjistik të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës,

Pajisja e Policisë së Burgjeve me uniforma përveç aspektit të prodhimit dhe garantimit të cilësisë kërkon një proces kompleks që përfshin:

1. Marrjen e masave individuale
2. Prodhimin në seri sipas specifikimeve teknike të miratuara, ku përfshihet repart i prerjes dhe i qepjes.
3. Kontrollin e cilësisë për çdo seri të prodhuar
4. Ambalazhimin/paketimi dhe shpërndarjen në kohë

Të gjitha këto faza kërkojnë një staf të mjaftueshëm të ndarë në funksione të ndryshme si prodhim, magazinim, menaxhim cilësie, logjistikë dhe administrim. Për këtë arsye përcaktimi i një numri punonjësish minimalisht prej 84 personash garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin e duhur njerëzor për të përballuar volumin dhe dinamikën e punës duke shmangur vonesat ose dështimet në furnizim dhe zbatim kontrate.

Zotërimi i punonjësve të kërkuar në list-pagesa për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është edhe një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Gjithshtu Autoriteti Kontraktor nëpërmjet këtij kriteri kërkon të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit të punësuar dhe njëkohësisht stabilitetin ekonomik në kuptimin e vazhdueshmërisë së kryerjes së pagesave financiare kundrejt personelit.

Nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri synohet të arrihet:

- a) Dëshmimi i kapacitetit teknik dhe profesional duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues kanë punonjës aktivë dhe me eksperiencë për të përmbushur kontratën;
- b) Verifikimi i pagesës së sigurimeve shoqërore dhe tatimore duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues respektojnë detyrimet ligjore ndaj punonjësve. Kërkesë kjo e përcaktuar edhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas së cilës operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në perfundim: Referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të uniformave të Policisë së Burgjeve, ato janë artikuj të cilat nuk gjenden lirisht në treg, por duhet të gjitha të prodhohen enkas për këtë procedurë prokurimi. Prodhimi i sasive të tilla të uniformave kërkon fuqi punëtore të konsiderueshme. Njësia e prokurimit ka bërë një analizë të thelluar të specifikimeve teknike dhe sasive të uniformave të cilat kërkohen të prodhohen për Policinë e Burgjeve. Në legjislacionin e vendit tonë nuk ekziston një bazë ligjore apo teknike ku mund të mbështetemi për të vendosur numrin e punonjesve fiks sesa nevojiten për të realizuar një kontratë të tillë, ndryshe nga punimet e ndërtimit psh, për të cilat ekziston një manual dhe një llogaritje bazuar në zërat e punimeve apo orët e punës që nevojiten për një proces të caktuar. Për këtë arsye, LPP i lë kompetencë AK-së që të vendosë kriteret për kualifikim në raport me rëndësinë, vështirësinë, fondin limit apo sasi të mallrave që do të prodhohen apo levrohen. Nga një hulumtim i përgjithshëm i fabrikave të prodhimit të veshjeve vihet re se për këtë objekt veprimtarie ka nevojë për fuqi punëtore në kufijtë e një fabrike, ku qoftë fuqia punëtore qoftë makineritë dhe paisjet janë në numër të konsiderueshëm dhe të domosdoshme për të realizuar prodhimin me shumicë. Bazuar në këto studime empirike, Njësia e Prokurimit propozon se numri minimalisht prej 84 punonjës, është një numër i domosdoshëm, për të krijuar bindjen se uniformat e policisë së burgjeve me të gjithë komponentët e tyre do të prodhohen në kohë dhe me cilësi si edhe duke repektuar të gjitha parashikimet e kodit të punës për orët, ditët e punës për punonjësit e prodhuesit.

Gjithashtu, Njësia e Prokurimit, gjykon se është e domosdoshme që kompania të ketë numër punonjësish për një periudhë 3 mujore. Sipas legjislacionit të punës (Kodi i Punës, Neni 150-

Periudha e provës, etj) që një marrëdhënie pune të konsiderohet e sukseshme duhet që punëmarrësi të ketë kaluar periudhën e provës 3 mujore. Kjo periudhë shërben që palët të njohin njëri tjetrin në aspektin e punës, nëse janë të përshatshëm, nëse punëmarrësi është i kënaqur me vëndin e punës dhe çfarë është më e rëndësishme nëse punëdhënësi vlerëson se punëmarrësi është i përshtatshëm dhe mund ta realizojë objektin e kontratës së punës. Për kontrata të tilla publike, me rëndësi për funksionimin dhe buxhetin e shtetit, Njësia e Prokurimit vlerëson se një fuqi punëtore e konsoliduar vërtetohet vetëm me këte numër punonjësish në listëpagesat e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës. Për arsye të pjesëmarrjes së kësaj procedurë prokurimi, operatori ekonomik mund të punësojë numrin e kërkuar të punonjësve për muajin e fundit, por pa kaluar periudha e provës, ky numër nuk është i saktë dhe nuk krijon bindjen që plotësohet. Punonjësit e punësuar rishtaz për këtë kontratë, nuk krijojnë siguri se janë të aftë dhe të gatshëm ta vazhdojnë marrëdhënien e punës, duke krijuar risk për zbatimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit, si njohese e Legjislacionit të prokurimeve Publike, gjykon se edhe nëse një operator ekonomik nuk e plotëson vetë numrin e kërkuar të punonjësve ligji lejon pjesëmarrjen në formën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik si dhe mbështetja në kapacitet të subjekteve të tjera për këtë kriter nuk është e ndaluar.

3. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të ketë staf teknik me kualifikimet si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Inxhinier tekstili	1
2	Stilist/Modelist veshjesh	2
3	Pergjegjes prodhimi/drejtues linje	2
4	Prestarë veshjesh/teknik prestarie	2
5	Punëtor të makinerive/ rrobaqepes	70
6	Punëtor hekuroses	2
7	Punëtor paketues	2
8	Punëtor shpërndarje	2
9	Shofer	1

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për inxhinierin e tekstilit të paraqitet:

- Diplomë që të vërteton kualifikimin profesional të mësipërm.
- Kontrate pune të vlefshme
- Inxhinieri i tekstilit duhet të kenë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

b) Për stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe përgjegjes prodhimi/drejtues linje të paraqitet për secilin:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional
- Kontrate pune e vlefshme.
- Stilist/modelist veshjesh, prestarë veshjesh/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

c) Per punetor te makinerive/ rrobaqepes/hekuroses

- kontrate pune e vlefshme
- duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

ç Per punetorin paketues

- kontrate pune e vlefshme

d) per punetor shperndarje te paraqitet

- kontrate pune e vlefshme

d) Per punonjesit shofer te paraqitet:

- Leje drejtimi mjete e vlefshme.
- Kontrate pune e vlefshme.

Shënim: Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm

për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...". Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: "3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit."

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Specifikimet teknike për artikujt objekt prokurimi, janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi "Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve", të ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr. 260 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve", i ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.

Referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të uniformave të Policisë së Burgjeve, ato janë artikuj të cilat nuk gjenden lirisht në treg, por duhet të prodhohen enkas për këtë procedurë prokurimi dhe detyrimisht operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë staf teknik të kualifikuar, sipas kërkesave të mësipërme, për realizimin e kontratës në përputhje me specifikimet teknike të miratuara nga Policia e Burgjeve. Nisur nga lloji i artikujve objekt prokurimi dhe specifikimet teknike të tyre, është kërkuar që një pjesë e stafit teknik të ketë eksperiencë pune minimale një ose dy vite në profilin përkatës siç është kërkuar në kriterin e mësipërm, me qëllim realizimin dhe përmbushjen e kërkesave specifike të kërkuara në specifikimet teknike për këtë objekt prokurimi. Autoriteti kontraktor përfituesi / konsumatori fundor i kësaj procedure është specifik, pasi bëhet fjalë për uniforma, aksesore dhe shenja dalluese të posaçme dhe jo për veshmbathje për përdorim të përgjithshëm.

Kriteri i përcaktuar më sipër, lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një operator ekonomik i cili nuk bind/garanton autoritetin kontraktor se me eksperiencën e tij mund të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi. Ky risk që shfaqet nga mungesa e kapaciteteve teknike është në disa drejtime si, kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e furnizimit brenda afateve kohore të parashikuara apo humbjet që mund të pësojë në kohë, nga moskryerja e furnizimit, gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik për shkak të paaftësisë së tij, mungesës së stafit teknik të kualifikuar dhe punëtorëve të tjerë apo mungesës së eksperiencës në furnizime mallrash të ngjashme. Gjithashtu, theksojmë, se referuar nenit 2 gërma "b" "Qëllimi" i ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se; "Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale". Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar "çmimit më të ulët"), por gjithashtu

shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga mungesa e eksperiencës dhe kapaciteteve teknike të operatorëve ekonomikë.

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale lëshohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Per Stafin teknik kryesor të kërkuar i referohemi Vendimit 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, si më poshtë:

Grupi i vogël

“Profesionistë të inxhinierisë (përjashtuar elektroteknologjinë)”

Kodi i profesionit: 214

Profesionistët e inxhinierisë (përjashtuar elektroteknologjinë) merren me projektim, planifikim, organizim, ndërtim, instalime dhe mirëmbajtje në fushën e ndërtimeve civile dhe industriale, në fushën mekanike, në fushën e mjedisit, në fushën e minierave apo të shpim-shfrytëzimit të naftës dhe gazit.

Ata/ato kryejnë kërkime për përmirësimin ose zhvillimin e koncepteve, teorive ose metodave operative, aplikojnë njohuritë ekzistuese në fusha përkatëse, mbikëqyrin proceset e prodhimit për të siguruar një efikasitet teknologjik dhe ekonomik. Ata/ato planifikojnë oraret e prodhimit dhe procedurat e punës për të siguruar projekte inxhinierike të sigurt, efikase dhe me kosto efektive. Ata/ato mund të punësohen në kompani biznesit të ndryshme në fushën e ndërtimeve civile dhe industriale, mekanike apo kimike, në fabrika e kombinate industriale, në fushën e minierave dhe të shpim-shfrytëzimit për naftën dhe gazin, etj. apo të vetëpunësohen.

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i arsimit të lartë.

b. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacioni shtesë

Kualifikimet pasuniversitare përbëjnë avantazh në punësim dhe zhvillim karriere.

Profesionet që klasifikohen në këtë grup profesionesh, në Listën Kombëtare të Profesioneve janë:

2141 Inxhinierë industrial dhe prodhimi

2142 Inxhinierë civilë

2143 Inxhinierë mjedisi

2144 Inxhinierë mekanikë

2145 Inxhinierë kimistë

2146 Inxhinierë minierash dhe profesionistëve të lidhura me to

2147 Inxhinierë metalurgë

2148 Inxhinierë naftë dhe gazi

2149 Inxhinierë të tjerë që nuk janë klasifikuar diku tjetër

Grupi-njësi (Profesioni)

“Inxhinierë industrial dhe prodhimi”

Kodi i profesionit: 2141

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Inxhinierë industrial dhe prodhimi”, niveli i katërt i kompetencës në LKP.

Inxhinieri industrial dhe i prodhimit, studion, dizajnon programe për koordinimin e veprimtarive prodhuese dhe vlerëson nëse janë kosto efektive dhe të sigurtat. Ai organizon dhe mbikëqyr procesin e prodhimit me qëllim nxjerrjen e produktit me cilësi të lartë, duke përdorur metodat efektive dhe me kosto të ulët, ndërsa redukton impaktin e dëmshëm tek mjedisi.

Funksionet kryesore Inxhinierët industrial dhe të prodhimit kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Studiojnë dhe dizajnojnë sisteme të reja ergonomike të projektimit të punës dhe procese prodhimi për produkte të reja ose për të përmirësuar ato ekzistuese;*
- b) Studiojnë strukturat organizative dhe informacionet e projektit për të përcaktuar funksionet dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe për të identifikuar zonat ku nevojitet dublimi i punëtorëve;*
- c) Krijojnë programe të matjes së punës së punëtorëve dhe analizojnë kampionë të pjesëve të punës për të përcaktuar standardet e përdorimit të punës në tërësi (normat e punës);*
- d) Organizojnë procesin e hapjes dhe mbylljes së veprimtarisë prodhuese, për të garantuar sa më pak humbje;*
- e) Përcaktojnë specifikimet për prodhimin, tipin e materialeve, pajisjet, tubacionet, rrjedhën e materialeve, kapacitetet etj. për procesin industrial dhe të prodhimit;*
- f) Vendosin standarde dhe politika për instalime, modifikime, kontrollin e cilësisë, testime, inspektime dhe mirëmbajtjen e impiantit në përputhje me parimet inxhinierike dhe rregullat e sigurisë në punë;*
- g) Inspektojnë procesin e prodhimit dhe japin zgjidhje për problematikat e hasura gjatë tij;*
- h) Bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë për të maksimizuar produktin, për të manaxhuar buxhetin, për të rekrutuar punonjës të kualifikuar, si dhe për t'i trajnuar ata;*
- i) Ekzaminojnë dhe tenderojnë pajisje të reja për të garantuar cilësi të lartë me çmimin më të mirë;*
- j) Drejtojnë mirëmbajtjen e ndërtesave dhe pajisjeve dhe koordinojnë kriteret për projekte të reja dhe grafikë të rinj të mirëmbajtjes.*
- k) Aplikojnë teknologjitë e avancuara inxhinierike për të përmirësuar produktin;*
- l) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit; m) Menaxhojnë personelin ndihmës;*
- n) Rritin aftësitë e veta profesionale.*

Kërkesat për punësim

a. Arsim i lartë, Inxhinieri prodhimi;

b. Aftësi analitike dhe komunikuese.

Informacion shtesë

Kualifikimet pasuniversitare përbëjnë avantazh në punësim dhe zhvillim karriere. Një individ mund ta nisë punën si një teknik inxhinierik për makineri prodhuese dhe industriale. Për këtë nevojitet arsim profesional para universitar. Me kryerjen e arsimit të lartë në Inxhinieri mund të punësohet si Inxhinier industrial dhe prodhimi. Me kualifikime dhe eksperiencë pune ai mund të marrë detyra drejtuese në sektorin ku realizon projektet inxhinierike. Mund të punojë edhe në institucione shkencore e kërkimore.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

2141.11 Inxhinier tekstilësh

Grupi-njësi (Profesioni)

“Përgjegjës prodhimi”

Kodi i profesionit: 3122

*Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve **“Përgjegjës prodhimi”**, niveli i tretë i kompetencës në LKP.*

Përgjegjësi i prodhimit siguron mbarëvajtjen e të gjithë procesit të prodhimit deri në produktin përfundimtar, sipas kërkesave të klientit. Ai planifikon, organizon, mbikëqyr dhe kontrollon punën e përditshme në lidhje me planet e prodhimit, personelit, pajisjet e makineritë, bazën materiale, llogaritjen e kostos apo kohës së punës etj., përdor dhe përgatit dokumentacion teknik, përgatit raporte të ndryshme apo dokumente të tjera dhe bashkëpunon me punëtorët, kontrollorët e cilësisë apo dhe drejtues të tjerë të prodhimit. Përgjegjësi i prodhimit orienton, udhëzon apo trajnon personelin për procese të ndryshme pune gjatë prodhimit. Ai mund të punësohet në kompani të shërbimeve të prodhimi apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore

Përgjegjësit e prodhimit kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Planifikojnë punën e përditshme në lidhje me planet e prodhimit, personelit, pajisjet e makineritë, bazën materiale etj.;*
- b) Organizojnë punën e përditshme në përputhje me planifikimet e bëra dhe teknologjitë përkatëse të prodhimit;*
- c) Kryejnë punë parapërgatitore për proceset e prodhimit (p.sh. përgatitje shablloni etj.);*
- d) Organizojnë proceset e prodhimit duke identifikuar hapat dhe burimet e nevojshme për zhvillimin e procesit të prodhimit;*
- e) Përcaktojnë planin e prodhimit dhe hapat përkatëse të procesit të prodhimit;*
- f) Përzgjedhin makineritë dhe pajisjet e duhura për proceset e ndryshme të punës;*
- g) Llogaritin kohën për çdo proces të prodhimit;*
- h) Përgatitin raporte të vlerësimit të kostos dhe të dhënat e tjera;*

- i) Kryejnë ndarjen e punës për çdo punonjës;
- j) Identifikojnë mungesën e personelit ose të komponentëve dhe marrin masat e duhura në raste të tilla;
- k) Orientojnë dhe udhëzojnë personelin për procese të ndryshme pune gjatë prodhimit;
- l) Kryejnë trajnimin e personelit të ri;
- m) Bashkërendojnë dhe mbikëqyrin veprimtarinë teknike të procesit të kontrollit;
- n) Bashkërendojnë dhe mbikëqyrin mirëfunksionimin e makinerive dhe pajisjeve të prodhimit;
- o) Mbikëqyrin ecurinë e procesit të prodhimit duke kërkuar zbatimin e standardit të cilësisë;
- p) Ndërhyjnë e zgjidhin problemet që dalin gjatë procesit të prodhimit;
- q) Përdorin dhe përgatitin dokumentacionin teknik apo dokumente të tjera;
- r) Realizojnë detyra të tjera të ngjashme;
- s) Komunikojnë me eprorët dhe vartësit në mënyrë profesionale;
- t) Bashkëpunojnë me të tjerët;
- u) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;
- v) Identifikojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- ë) Respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- x) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së shëndetit në punë ;
- y) Zbatojnë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

Kërkesat për punësim

- a. Zakonisht kërkohet përfundimi i studimeve bachelor ose një shkolle profesionale në këtë fushë:
- b. Preferohet të ketë 2 vjet përvojë të mëparshme në fazat ndryshme të prodhimit;
- c. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

- a. Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës. Me eksperiencë dhe me kualifikim të mëtijshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një përgjegjës prodhimi mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel drejtues prodhimi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit në fushat përkatëse të prodhimit.
- b. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.
- c. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme të tilla si: Përgjegjës për përpunimin e konfeksioneve, përgjegjës për përpunimin e lëkurës, përgjegjës për përpunimin e letrës, përgjegjës për përpunimin e metaleve, përgjegjës për përpunimin e plastikës, përgjegjës për përpunimin e tekstileve, përgjegjës për përpunimin të produkteve ushqimore etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 3122.01 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e dheut
- 3122.02 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit
- 3122.03 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e kabllave elektrike.
- 3122.04 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e konfeksioneve**

3122.05 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e lëkurës
 3122.06 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e leshit
 3122.07 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e letrës
 3122.08 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e metaleve
 3122.09 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e plastikës
 3122.10 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e produkteve të gomës
3122.11 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e tekstileve
 3122.12 Përgjegjës prodhimi për përpunimin të produkteve ushqimore
 3122.13 Përgjegjës sektori në prodhim
 3122.14 Përgjegjës turni në prodhim industrial
 3122.15 Përgjegjës turni
 3122.16 Brigadier në prodhim
 3122.17 Kontrollues i cilësisë së prodhimit në tekstil-konfeksione
 3122.18 Kontrollues i cilësisë së prodhimeve të lëkurës
 3122.19 Kontrollues i cilësisë së prodhimit në industrinë ushqimore
 3122.20 Kontrollues i cilësisë së prodhimi

Grupi-njësi (Profesioni)

“Modelistë, prestarë dhe punonjës të tjerë të ngjashëm”

Kodi i profesionit: 7532

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Modelistë, prestarë dhe punonjës të tjerë të ngjashëm”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Modelisti, prestari dhe punonjës të tjera të ngjashëm, krijon modele pune të përpikta për prodhimin e rrobave dhe tekstileve të tjera, si edhe ato prej lëkure dhe gëzofti. Ai vijëzon, pret, jep formë dhe stolis tekstile, lëkurë të lehta dhe materiale të tjera në bazë të specifikimeve për prodhimin e veshjeve, kapelave dhe kasketave, dorashkave dhe produkteve të tjera të ndryshme. Prerësi i modeleve kryen rolin e një ndërmjetësi midis stilistit dhe punuesit apo prodhuesit të tekstileve, lëkurës apo të tjera të ngjashme.

Funksionet kryesore Modelistët, prestarët dhe punonjës të tjera të ngjashme kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Krijojnë modele punimi për çdo madhësi brenda një numri veshjesh të ndryshme, duke përdorur tabela modelimi, mjete kompozimi, kompjuter dhe pajisje të caktimit të përmasave;*
- b) Testojnë modele duke bërë dhe provuar veshje prove;*
- c) Hedhin në kompjuter skica modelesh dhe krijojnë modele për një dizajn të veçantë veshje me ndihmën e kompjuterit;*
- d) Llogaritin përmasat e modeleve të formuara sipas madhësive, duke pasur parasysh edhe shtrirjen e materialit;*
- e) Vizatojnë detajet në pjesët e përvijuara për të treguar se ku ato janë për t'u bashkuar, pozicionet e palave, xhepave, vrimat e pullave të rrobave, të qepjeve dekorative në pjesët e këpucëve apo të fliqeve mbi kanavacë, duke përdorur kompjuter ose mjete të tjera të hartimit të skicave;*
- f) Përgatitin modele për veshje të ditës dhe për ato të mbrëmjes;*
- g) Krijojnë modele kryesisht me dorë , por mund të përdorin edhe sisteme të kompjuterizuara;*

- h) U përgjigjen kërkesave për modele për ngjarje të veçanta, individë të shquar, si edhe kërkesave të tjera;
- i) Modifikojnë modelet ekzistuese dhe hartojnë modele të reja;
- j) Kryejnë punime të tjera të ngjashme si këto;
- k) Zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;
- l) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës.

Kërkesat për punësim

- a. Të ketë mbaruar arsimin e detyruar;
- b. Shkolla e mesme profesionale në fushë të ngjashme përbën përparësi;
- c. Të ketë eksperiencë disa vjeçare në punë - puna në atelie rrobaqepësie përbën favor;
- d. Të jetë e/i aftë të përdorë pajisjet matëse dhe ato prerëse me precizion të lartë e të saktë;
- e. Të jetë e/i aftë të punojë dhe të presë modele të reja veshjes prej lëkure e tekstili;
- f. Të jetë e/i motivuar dhe pjesë e procesit krijues;
- g. Të ketë komunikim të shkëlqyer dhe aftësi ndërpersonale;
- h. Të ketë dhënë prova se mund të bashkëpunojë lirshëm me drejtuesit më të lartë;
- i. Të ketë krijueshmëri, fleksibilitet, iniciativë dhe saktësi në përgjigje të nevojave të modelimit;
- j. Të jetë e/i aftë të tregojë vëmendje në detaje;
- k. Të tregojë përkushtim për rritjen e njohurive dhe përmirësimin e aftësive. Informacion shtesë

Kurset e trajnimit të japin ndihmë shumë të madhe për të gjetur punë në këtë profesion. Prerësit e modeleve zakonisht vendosen në një studio apo dhomë pune e cila duhet të jetë e ndriçuar mirë. Përdorimi i kompjuterit sa vjen e bëhet më i domosdoshëm. Pas kalimit të një eksperience të gjatë dhe të suksesshme individ mund të marrë titullin mjeshtër dhe mund të hapë një atelie të vetën. Shkollimi i mëtejshëm kërkon në nivele pas të mesme ofron mundësi për të ushtruar profesionin si dizajnues mode. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 7532.01 Modelist dorezash
- 7532.02 Modelist dyshekësh
- 7532.03 Modelist i gëzofëve
- 7532.04 Modelist kapelash
- 7532.05 Modelist ombrellash
- 7532.06 Modelist rrobash**
- 7532.07 Modelist tapicerish
- 7532.08 Modelist tendash
- 7532.09 Modelist veshjesh**
- 7532.10 Modelist veshjesh popullore
- 7532.11 Montues dyshekësh
- 7532.12 Prerës dorezash
- 7532.13 Prerës dysheku
- 7532.14 Prestar veshjesh**
- 7532.15 Prestar i ombrellave
- 7532.16 Prestar i tapicerive
- 7532.17 Prestar i tendave
- 7532.18 Prestar rrobaqepës

7532.19 Punues jorganësh

7532.20 Prestar

7532.21 Prestar gëzofi

Grupi-njësi (Profesioni)

“Punëtorë qepës të tjerë”

Kodi i profesionit: 7533

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë qepës të tjerë”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Punëtorët qepës të tjerë prodhojnë, përshtatin dhe riparojnë rroba për veshje të qepura me makinë ose të punuara me dorë. Ata prodhojnë rroba të bëra sipas masës së marrë për veshje të tilla si kostume, pallto e pardesy, fustane të bëra nga copa prej pëlhure, tekstili, punime prej lëkure të lehtë, plush dhe materiale të tjera. Ata bëjnë kapele apo paruke sipas specifikave të konsumatorëve dhe sipas prodhuesit të veshjeve.

Funksionet kryesore: Punëtorë qepës të tjerë kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Bëjnë pallto, kostume, funde, këmisha, bluza, të brendshme, korse, kapele, paruke dhe veshje të ngjashme, kryesisht sipas kërkesave të paraqitura nga ana e klientëve individuale;*
- b) Përzgjedhin pëlhura tekstile, lëkurë apo material për peliçe të cilat përputhen me madhësinë e dëshiruar, ngjyrën, përbërjen dhe cilësinë e rrobës;*
- c) Marrin masat e klientit duke përdorur metër shirit dhe mbajnë shënim matjet e gjetura;*
- d) Presin copat për t'i dhënë atyre formën e modeleve të veshjeve dhe i rregullojnë ato në modele në përputhje me dizajnin e përcaktuar të veshjeve;*
- e) Bëjnë ndryshime në stil veshje, të tilla si ngushtimin në fund të këmbëzave të pantallonave, ngushtimin e jakës së xhaketës si edhe vendosin apo heqin vata;*
- f) Përzgjedhin dhe modifikojnë modelet komerciale për klientët dhe prodhuesit e veshjeve sipas specifikimeve dhe të përputhshmërisë;*
- g) Përshtatin, ndryshojnë dhe riparojnë veshje të qepura më përpara, të tilla si fustane, xhaketa dhe veshje të tjera të bëra me masë sipas kërkesave të klientëve;*
- h) Punojnë dhe kujdesen për veshje e pajisje që përdoren në jetën e përditshme si edhe në shfaqje teatrale, televizive dhe në prodhimet kinematografike të tilla si kostume, punime të lëkurës, gëzof, dorashka, çadra, zbukurime të veshjeve popullore etj. ;*
- i) Përthyejnë, përdredhin dhe stolisin materiale të tilla si atillas ose mëndafsh;*
- j) Qepin fjongo apo copëza në formën e luleve artificiale apo harkojnë në rreth kurorë dhe dekorojnë kapele rreth e qark tyre;*
- k) Qepin dhe bashkojnë materiale dhe fill flokësh për të bërë paruke;*
- l) Përziejnë hijet e ngjyrave të flokëve për t'i dhënë pamjen natyrore parukeve;*
- m) Rregullojnë flokët e punuar në pozicionin e përcaktuar dhe bashkojnë flokët me qepje për të formuar pjesë të parukës;*
- n) Punojnë, ndryshojnë, ristilojnë dhe riparojnë veshje plush dhe artikuj të tjerë të bërë prej tij;*
 - o) Rimarrin copa plushi apo lëkure nga veshjet e vjetra, i ngjitin pëlhurë nga ana e brendshme dhe i zbukurojnë veshjet prej lëkure;*

- p) Presojnë, hekurosin veshjet duke përdorur hekur dore apo makineri presuese;
- q) Kryejnë punime të tjera të ngjashme si këto;
- r) Zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;
- s) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës.

Kërkesat për punësim

- a. Të ketë mbaruar arsimin e detyruar;
- b. Kualifikimi profesional në fushë të ngjashme përbën përparësi;
- c. Të ketë eksperiencë disa vjeçare në punë; puna në punishte rrobaqepësie përbën favor;
- d. Të jetë i aftë të përdorë pajisjet matëse, prerëse dhe qepëse me precizion të lartë e të saktë;
- e. Të jetë e/i aftë të masë dhe të qepë modele të reja veshjesh prej materialeve të ndryshme që përdoren për veshje;
- f. Të jetë e/i motivuar dhe pjesë e procesit krijues, të njohë dhe kuptojë trendin e kohës;
- g. Të ketë komunikim të shkëlqyer dhe aftësi ndërpersonale;
- h. Të ketë dhënë prova se mund të bashkëpunojë lirshëm me drejtuesit më të lartë;
- i. Të ketë krijueshmëri, fleksibilitet, iniciativë dhe saktësi në përgjigje të nevojave të modelimit;
- j. Të jetë e/i aftë të tregojë saktësi dhe vëmendje në detaje;
- k. Të tregojë përkushtim për rritjen e njohurive dhe përmirësimin e aftësive;
- l. Të njohë shumë mirë punimet e qepjes me dorë dhe me makinë qepëse;
- m. Të jetë e/i aftë në komunikim me klientin dhe të qetësojë ata me takt e kujdes;
- n. Të jetë personalisht i veshur hijshëm dhe pastër.

Informacion shtesë

Në këtë profesion mund të futesh duke mësuar nga një mjeshtër zanati. Mund të merret takim i drejtpërdrejtë me ustain mjeshtër ose mund të gjenden mënyra të tjera prej informimit në shtyp ku mund të tregohen aftësitë që zotërohen dhe angazhimi për të kryer një punë të tillë. Nëse kërkohet që të zhvillohen më tej aftësitë atëherë duhet gjetur mënyra për të ndjekur kurse të zhvillimit të këtij profesioni, të cilat nuk kërkojnë kohë të gjatë për të marrë elementët bazë të tij. Për të filluar punën si aktivitet privat, kërkohet të jesh i regjistruar në QKB dhe të plotësosh detyrimet që rrjedhin prej akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 7533.01 Prodhues çadrash
- 7533.02 Prodhues i luleve artificiale
- 7533.03 Prodhues lodrash/kukullash dhe lodra të mbushura
- 7533.04 Prodhues lodrash plastike
- 7533.05 Prodhues qilimash
- 7533.06 Prodhues tendash
- 7533.07 Prodhues velash
- 7533.08 Qepës çizmesh
- 7533.09 Qepës dyshekësh
- 7533.10 Qepës gëzofësh
- 7533.11 Qepës kapelash
- 7533.12 Qepës lëkurash
- 7533.13 Qepës tapicerish

7533.14 Qepës tekstilësh

7533.15 Qepës tendash

7533.16 Qepës velash

7533.17 Qepës veshjesh

7533.18 Qepës veshjesh popullore

7533.19 Rruazarë/punëtor të montimit të rruazave të ndryshme

7533.20 Punonjës punimesh dore në produkte tekstili

Shembuj të profesioneve/punësimeve të ngjashme që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

7318 Punëtorë të prodhimit të maskave

8153 Punëtorë të makinave qepëse

7531 Rrobaqepës (fustane, kapele, gëzof etj.)

Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh” Kodi i profesionit: 8322

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Shoferi i makinave, taksive dhe furgonave merret me transportin e udhëtarëve, mallrave, postës, etj. Ai drejton mjetet motorike duke u kujdesur për një transport të sigurt dhe të përshtatshëm duke zbatuar rregullat e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Ai mund të punësohet në kompani shërbimesh të ndryshme, shërbimesh transporti apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore Shoferët e makinave, taksive dhe furgonave kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kontrollojnë mjetin motorik para fillimit të punës; b) Drejtojnë mjetet motorike për të transportuar udhëtarë, mallra, postën etj; c) Kujdesen për transportimin sigurt të mallrave dhe udhëtarëve; d) Ndihmojnë pasagjerët për bagazhet e tyre; e) Kontrollojnë çmimet dhe pagesat për dërgesat ose dokumente që vërtetojnë dërgesat dhe grumbullojnë pagesat përkatëse; f) Përdorin pajisjet operative të telekomunikacionit për të raportuar vendndodhjen dhe disponueshmërinë e tyre; g) Ndjekin udhëzimet e kontrollit të qendrës së shoqërisë së transportit; h) Përcaktojnë rrugën më të përshtatshme për të arritur në destinacion; i) Ndihmojnë pasagjerët me aftësi të kufizuara fizike, në lëvizjet e tyre; j) Përdorin pajisje për të lehtësuar ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave apo lëvizjen e udhëtarëve me aftësi të kufizuara fizike; k) Zbatojnë rregulloren e transportit rrugor për mallra dhe udhëtarë; l) Kryejnë shërbime të mirëmbajtjes periodike të mjetit motorik; m) Bëjnë llogaritjet dhe plotësimin e faturës përkatëse për punën e kryer; n) Pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetin e punës dhe e lënë atë në gjendje të gatshme për punë; o) Realizojnë detyra të ngjashme; p) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; q) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit të kërkuar nga organet përkatëse. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë fushë përbën avantazh. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një drejtues i makinave, furgonëve dhe motoçikletave mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel mbikëqyrësi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier mekanik. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e transportit duhet leje drejtimi për mjetin përkatës dhe regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: shofer ambulance, shofer kamionçine, shofer taksie, shoferë furgonësh etj.

“Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport”

Kodi i profesionit: 93

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport”, niveli i parë i kompetencës në LKP. Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë detyra të thjeshta dhe rutinë, në miniera, gurore, ndërtimit, prodhimit, punë transporti, magazinimi, seleksionimi dhe paketimi, duke punuar me krahë, makineri dhe pajisje të pa motorizuara, apo karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshë. Ata kryejnë shërbime ndihmëse, kryesisht punë që kërkojnë aftësi fizike dhe pak njohuri. Ata mund të punësohen në kompani të punimeve dhe shërbimeve të ndryshme, apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore: Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë guroret; b) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë miniera; c) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë hekurudha; d) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë diga; e) Kryejnë punë krah në ndërtim dhe mirëmbajtje rrugësh; f) Kryejnë gërmime dhe heqje dheu me lopatë, duke përdorur mjete dore apo pajisje të thjeshta; g) Kryejnë hapje të kanaleve, puseve të ujit; h) Kryejnë shembje të ndërtimeve me pajisje dore; i) Kryejnë punë krah në ndërtim; j) Kryejnë mirëmbajtje të ndërtesave të ndryshme; k) Bëjnë mbushje të kontejnerëve dhe rafteve me produktet e duhura; l) Kryejnë punë krah në industri të ndryshme; m) Kryejnë ambalazhime të ndryshme me dorë; n) Seleksionojnë materiale të ndryshme në vendet e grumbullimit të tyre; o) Ndezin zjarr dhe ndihmojnë në impiante të ngrohjes së ujit; p) Punojnë me karroca dhe pajisje të tjera të pa motorizuara për ngarkim-shkarkim mallrash të ndryshme; q) Drejtojnë dhe punojnë me karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshët; r) Ngarkojnë dhe shkarkojnë materiale ndërtimi; s) Ngarkojnë dhe shkarkojnë mallra të ndryshme në anije, në avion, në kamionë, në pajisjet frigoriferike, apo magazina të ndryshme etj; t) Sistemojnë dhe paketojnë mall për transport; u) Realizojnë detyra të ngjashme; v) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; w) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i arsimit të detyruar.

b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

“Punëtorë ngarkim-shkarkimi”

Kodi i profesionit: 9333

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë ngarkim-shkarkimi”, niveli i parë i kompetencës në LKP.

Punëtori ngarkim-shkarkimi zhvendos, ngarkon dhe shkarkon mallra të ndryshme, me krahë dhe pajisje të thjeshta. Ai gjithashtu mbart, ngarkon dhe shkarkon mobilie dhe të sendeve të tjera të ngjashme shtëpiake. Ai ngarkon dhe shkarkon mallra prej anijeve, avionëve, vagonëve si edhe në magazina të ndryshme.

Funksionet kryesore Punëtorët e ngarkim-shkarkimit kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Paketojnë orendi shtëpiake apo mobilie zyrash, pajisje dhe mallra të tjera të ngjashme të cilat duhet të transportohen nga një vend në tjetrin;*
- b) Transportojnë mallra për t'u ngarkuar ose shkarkuar nga furgonë, kamionë, vagonë, anije, apo avionë;*
- c) Ngarkojnë dhe shkarkojnë drithëra, qymyr, rërë dhe mallra të ngjashme duke i vendosur ato në mjete transportuese si konvejerë apo tuba shkarkimi etj;*
- d) Lidhin tubat midis gypave kryesore të instalimit në breg të cisternave, depozitave dhe anije të tjera për të ngarkuar dhe shkarkuar naftë, gaze të lëngshëm dhe lëngje të tjera;*
- e) Transportojnë dhe bëjnë stivë mallra në depo dhe ndërtesa të ngjashme; f) Ndajnë dhe klasifikojnë ngarkesa para ngarkimit dhe shkarkimit;*
- g) Kryejnë punë të tjera të ngjashme si këto;*
- h) Zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;*
- i) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës.*

Kërkesat për punësim

Nuk kërkohet ndonjë kualifikim formal; trajnimi dhe eksperiencia merren gjatë punës. a. Nëse ngarkoni e shkarkoni mallra e bagazhe prej avionëve atëherë duhet të merrni trajnime të veçanta, posaçërisht të lidhura me këtë profesion. b. Duhet pasur shikueshmëri dhe dëgjim shumë i mirë. Informacion shtesë Individidi mund të punësohet në kompani transporti për mallra ndërtimi me kamionë me anije apo me tren. Ata që mund të punësohen në industrinë e transportit me avionë duhet të marrin dëshmi apo garanci për figurë të pastër të personit. Gjithashtu një treg i mirë i punësimeve në këtë profesion janë kompanitë e riciklimit të mbetjeve, magazinat dhe tregjet e mëdha ushqimore, si edhe frigoriferët e mëdhenj të cilët ruajnë mallra në temperatura të caktuara për një kohë të gjatë. Pas fillimit të punës mund të merret eksperiencë e mirë për të ecur në karrierë si përgjegjës i brigadës së punëtorëve të ngarkim shkarkimit.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

9333.01 Punëtor ngarkim-shkarkimi mbetjesh urbane
 9333.02 Punëtor ngarkim-shkarkimi për materiale ndërtimi
9333.03 Punëtor ngarkim-shkarkimi
9333.04 Punëtorë ngarkim-shkarkimi mallrash
 9333.05 Punëtor ngarkim-shkarkimi mobiliesh
 9333.06 Punëtor ngarkim-shkarkimi në anije
 9333.07 Punëtor ngarkim-shkarkimi në avion
 9333.08 Punëtor ngarkim-shkarkimi në kamionë
 9333.09 Punëtor ngarkim-shkarkimi në pajisjet frigoriferike
 9333.10 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tregun ushqimor
 9333.11 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tren

Argumentim: Ne lidhje me numrin e punonjesve

Organizimi i Burimeve Njerëzore për Prodhimin e Uniformave të Policisë

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Inxhinier tekstili	1
2	Stilist/Modelist veshjesh	2
3	Pergjegjes prodhimi/drejtues linje	2
4	Prestarë veshjesh/teknik prestarie	2
5	Punetor te makinerive/ rrobaqepes	70
6	Punëtor hekuroses	2
7	Punëtor paketues	2
8	Punëtor shpërndarje	2
9	Shofer	1

- Inxhinieri i Tekstilit:** Një inxhinier tekstili do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen dhe kontrollin e materialeve, duke u siguruar që ato plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara.
- Stilist/Modelist Veshjesh:** Për stilimin dhe modelimin e uniformave, do të jenë dy punonjës. Kjo për shkak të sasive të mëdha dhe shumëllojshmërisë së veshjeve që duhen prodhuar.
- Përgjegjës Prodhimi/Drejtues Linje:** Për organizimin dhe mbikëqyrjen e linjës së prodhimit, do të nevojiten dy persona, për të përballuar volumet dhe diversitetin e produkteve.
- Prerës Veshjesh/Teknik Presatie:** Dy punonjës do të merren me procesin e prerjes së materialeve, një hap kritik përpara fillimit të procesit të qepjes.
- Punëtor Makinerish/Rrobaqepës:** Janë planifikuar 70 punonjës për procesin e qepjes, që është më voluminozi dhe kërkon më shumë burime njerëzore. Procesi është zinxhiror, ku çdo hallkë lidhet ngushtë me tjetrën.
- Punëtor Hekurosës:** Për hekurosjen e veshjeve, do të jenë minimalisht dy punonjës, një numër që mund të rritet gjatë zbatimit të kontratës, nëse është e nevojshme, në bazë të sasive të nevojshme për përfundimin e këtij procesi.

7. **Punëtor Paketues:** Për paketimin e produkteve pas përfundimit të prodhimit, janë planifikuar minimalisht dy punonjës. Edhe ky numër mund të rritet gjatë zbatimit të kontratës, nëse kërkohet.

Tipologjia e Prodhimit Duke qenë se kërkohet një sasi e madhe uniformash komplekse, prodhimi do të realizohet në fabrika të mëdha dhe jo në punishte të vogla. Uniformat e policisë përfshijnë detaje si aksesoret dhe gradat, gjë që i bën ato më komplekse për prodhim dhe kërkojnë një standard të lartë pune dhe përpunimi.

Personeli tjetër ndihmës si shofer dhe punonjës shpërndarje (ngarkim- shkarkim) vijnë në ndihmë për transportin e mallit të kërkuar në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues dhe shpërndarjen e tyre. Referuar shtojcës 7 janë përcaktuar termat e referencës në lidhje me zbatimin e kontratës, ku është përcaktuar se Artikujt e Uniformës dhe të Këpucëve të Policisë së Burgjeve do të magazinohen në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me qendër në Tufinë dhe në Vaqarr. Në raste të ndryshimit të vendit të magazinimit operatori fitues do të njoftohet zyrtarisht.

4. Operatori ekonomik duhet të disponojë makinerite si më poshtë:

- Makineri prerje automatike (sistemi (CUT)- minimalisht 1 copë
- Makina qepëse – minimalisht 70 copë
- Makineri hekurosje- minimalisht 2 copë

Për makineritë dhe pajisjet e deklaruar sipas kësaj pikë të provohet diponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi si më poshtë:

- fatura shit - blerje ose
- kontrata shit - blerje ose
- kontratë qeraje ose
- kontratë huapërdorje.

Shënim: Kriteri nr. 4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të

shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”, këto mjete janë minimale të kërkuara për realizimin e objektit të prokurimit që duhet të disponojnë operatorët ekonomike. Këto makineri shërbejnë për procese të punës si më poshtë:

- Makineria për prerje automatike është një pajisje industriale e përdorur në rrobaqepësi për të prerë me saktësi dhe shpejtësi materialet tekstile sipas modeleve dhe përmasave të dëshiruara. Kjo teknologji është veçanërisht e rëndësishme në prodhimin e uniformave ushtarake dhe policore, ku kërkohen precizion, efikasitet dhe një cilësi e lartë e prerjes. Burimet njerëzore janë të nevojshme dhe të domosdoshme në disa faza të caktuara të prodhimit. Në këtë kuptim njësia e prokurimit konsideron faktin që edhe pse produkti final mund të jetë njësoj përsa i përket cilësisë, një operatori ekonomik që konkuron me deklarin dhe paraqitjen e një makinerie të tillë gjysëm automatike do t’i duhej më shumë kohë për realizimin e këtij procesi dhe rrjedhimisht ekziston një risk potencial në zbatimin e kontratës. Pra, kërkesa për një makineri të tillë automatike lidhet me një proces prodhimi komplet automatik dhe më të shpejtë fakt ky i lidhur ngushtësisht edhe me afatin total të zbatimit të kontratës dhe lëvrimit të mallit. Koha/afati është një komponent i rëndësishëm i procesit të prokurimit krahas komponentit çmim dhe cilësi dhe kriteret kualifikuese lidhen ngushtësisht me këto tre komponentë.

- Makineria qepëse, nëpërmjet të cilave kryhen procese të ndryshme gjatë prodhimit të një artikulli, është një pajisje thelbësore në industrinë e rrobaqepësisë dhe përdoret për të bashkuar, qepur, përforcuar pjesët e materialeve tekstile, vendosur komca, qendisje etj. Në prodhimin e uniformave ushtarake dhe policore, makineritë qepëse duhet të jenë të fuqishme, të sakta dhe të përshtatshme për materiale të ndryshme, duke përfshirë stoffin e trashë dhe tekstilet teknike.

-Makina e hekurosjes është një pajisje thelbësore në procesin e prodhimit të uniformave ushtarake dhe policore. Ajo siguron një përfundim profesional duke larguar rrudhat, fiksuar palosjet dhe formësuar materialin sipas standardeve të kërkuara.

Makineritë janë vendosur në propocion me disa elementë sic janë fondi limit, natyra e mallit që prokurohet, specifikimet teknike dhe proceset e punës që kërkohen të realizohen nëpërmjet makinërive automatike dhe numri i punonjësve që do të përfshihen në këtë proces. Si dhe ne perputhje me nurmin e punonjesve te kerkuar.

Tipologjia e Prodhimit Duke qenë se kërkohet një sasi e madhe uniformash komplekse, prodhimi do të realizohet në fabrika të mëdha dhe jo në punishte të vogla. Prosesi i prodhimit eshte nje proces zinxhior, ku proceset nuk mund te zhvillohen vecmas njeri tjetrit, ndaj eshte gjykuar numri 70 (shtatedhjetë) makinave qepese kjo ne perputhje edhe me numrin e rrobaqepeseve te kerkuar. Uniformat e policisë përfshijnë detaje si aksesoret dhe gradat, gjë që i bën ato më komplekse për prodhim dhe kërkojnë një standard të lartë pune dhe përpunimi.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- 1) ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- 2) ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- 3) ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- 4) ISO 28001 “Për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- 5) ISO 22301 “Për sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të

menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

ISO 28001 është një standard ndërkombëtar që lidhet me menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit dhe ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në sigurinë e zinxhirit të furnizimit. Ky standard është i rëndësishëm kur bëhet fjalë për të siguruar që procese të tilla si blerja e uniformave të realizohen në një mënyrë të sigurt dhe efektive, duke përfshirë aspekte të tilla si mbrojtja nga rreziqet në zinxhirin e furnizimit.

Në një procedurë prokurimi për blerje uniformash, implementimi i ISO 28001 mund të jetë i nevojshëm për disa arsye:

- a) Siguria dhe Cilësia e Produkteve: Me këtë standard, siguroheni që furnizuesit dhe distributorët e uniformave respektojnë kriteret e sigurisë dhe cilësisë, duke minimizuar mundësinë e problematikave si produktet e substandardëve që mund të dëmtojnë reputacionin ose sigurinë e punonjësve.
- b) Mbrojtja nga Rreziqet në Zinxhirin e Furnizimit: ISO 28001 ofron një qasje të strukturuar për menaxhimin e rreziqeve që mund të shfaqen gjatë furnizimit të uniformave, si vonesa, cilësi të dobët, ose probleme me logjistikën që mund të ndikojnë në funksionimin e normalizuar të organizatës.
- c) Përmeshja e Rregullave dhe Standardeve Ligjore: Nëse kompania ose organizata juaj vepron në një sektor ku kërkohen standarde të sigurisë (si në industrinë e shëndetësisë, ushtrinë, ose kompani të tjera me kërkesa specifike), përdorimi i ISO 28001 mund të ndihmojë për të siguruar që çdo procedurë e prokurimit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare.
- d) Siguria e Informacionit dhe Trajnimi: Ky standard ndihmon gjithashtu në mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit që mund të lidhen me proceset e furnizimit dhe prokurimit, përfshirë informacionet sensitive që mund të lidhen me uniformat e furnizuara dhe dërgesat.

Nëse është e mundur, ky standard mund të jetë i dobishëm për të siguruar një proces prokurimi transparent dhe të besueshëm, që maksimizon mundësitë për të marrë produkte të cilësisë së lartë dhe të sigurtë.

ISO 22301 është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit (Business Continuity Management System – BCMS), që ofron udhëzime për zhvillimin, implementimin dhe mbajtjen e një plani të efektshëm për të siguruar që një organizatë mund të vazhdojë funksionimin e saj edhe në kushte krize ose pas ndodhisë së një ngjarje të papritur. Ky standard është i rëndësishëm për të siguruar që organizata mund të mbajë një nivel të lartë të shërbimeve dhe produkteve të saj, edhe në situata emergjente.

Në kontekstin e një procedure për blerjen e uniformave, përdorimi i ISO 22301 është i rëndësishëm për disa arsye kryesore:

1. Sigurimi i Vazhdueshmërisë së Furnizimit

- Nëse një organizatë ka një plan prokurimi për uniforma, ndodhin shpesh situata ku furnizuesit mund të kenë vonesa, probleme të prodhimit ose mungesë të lëndëve të para.

Nëse është e mundur, një sistem i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit do të mundësojë që organizata të ketë mekanizma të gatshëm për të siguruar furnizim të pandërprerë, madje edhe në rast të problemeve të papritura.

- ISO 22301 ndihmon në identifikimin dhe minimizimin e rreziqeve që mund të dëmtojnë zinxhirin e furnizimit, duke siguruar që, nëse ka probleme me furnizuesit ekzistues, të ketë opsione alternative për të siguruar uniformat e nevojshme.

2. Rëndësia e Planifikimit për Situata Emergjente

- Në rast të krizave të papritura (p.sh., fatkeqësi natyrore, ndërprerje të furnizimeve, ose probleme me transportin), një sistem i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit mund të ndihmojë për të siguruar që blerja e uniformave të vazhdojë pa probleme, duke minimizuar ndalimet në operacionet e përditshme.
- ISO 22301 ndihmon në krijimin e një plani të qartë dhe të strukturuar për të menaxhuar situatat emergjente që mund të ndikojnë në procesin e blerjes, si për shembull ndalesa të paplanifikuara të prodhimit nga furnizuesit, apo problemet me shpërndarjen.

3. Menaxhimi i Rreziqeve të Furnizuesve

- Ky standard gjithashtu ndihmon për të siguruar që organizata të ketë një sistem për të menaxhuar rreziqet që mund të vijnë nga furnizuesit e uniformave, si dhe për të vlerësuar vazhdimisht performancën e tyre. Nëse një furnizues nuk mund të plotësojë kërkesat për shkak të një krize ose ngjarjeje, ISO 22301 ndihmon në sigurimin e alternativeve, të cilat mund të ndihmojnë për të mbajtur vazhdimësinë e furnizimeve.

4. Përmirësimi i Besueshmërisë dhe Reputacionit të Organizatës

- Implementimi i ISO 22301 mund të ndihmojë për të rritur besueshmërinë e një organizate për klientët dhe partnerët e saj. Kur një kompani tregon që ka një sistem të menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit, ajo tregon angazhimin për të garantuar që operacionet e saj nuk do të ndalojnë, pavarësisht nga situatat e jashtme.
- Për blerjen e uniformave, kjo do të thotë që do të mund të siguroheni që ndonëse mund të ketë çështje të jashtme që prekin zinxhirin e furnizimit, organizata juaj mund të vazhdojë të ofrojë produkte dhe shërbime pa ndërprerje.

5. Përgatitja dhe Trajnimi i Personelit

- ISO 22301 përfshin gjithashtu trajnimin dhe përgatitjen e personelit për të reaguar në mënyrë të shpejtë dhe efikase në situata emergjente. Ky është një faktor i rëndësishëm në menaxhimin e procedurave të prokurimit, duke siguruar që në rast emergjence, stafi i përfshirë në prokurimin e uniformave mund të veprojë shpejt dhe me efikasitet.

Përfundim:

Përdorimi i ISO 22301 në procedurën për blerjen e uniformave është i rëndësishëm për të siguruar që proceset e furnizimit të mos ndërpriten dhe që çdo krizë ose ngjarje e papritur të menaxhohet në mënyrë efektive. Kjo do të sigurojë që organizata të mund të vazhdojë funksionimin e saj pa ndërprerje, duke ruajtur reputacionin dhe besueshmërinë e saj në treg.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Çertifikatën OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, për të vërtetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX standard 100 të tekstileve ose ekuivalente. Në mungesë të certifikimit OEKO-TEX standard 100 të tekstileve ose ekuivalente, do të pranohen raportet e testimit të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX.

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 e 3 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.... 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.”* Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Referuar specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, Njësia e Prokurimit gjykon se është e domosdoshme paraqitja e certifikatës OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, pasi është standarti që përfshin artikujt që kanë kontakt direkt me lëkurën dhe është në përputhshmëri me rregulloren e Bashkimit Europian që synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të kimikateve (Registration, Evaluation, Authorization and Restriction of Chemicals –REACH), duke përfshirë kufizimet për substanca të caktuara të rrezikshme. Ky standart certifikon produktet, pasi janë të testuara për substanca të dëmshme duke siguruar që të jenë të sigurt dhe të mbrojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga kimikatet toksike.

Cdo komponent i një produkti që nga lënda e parë (metrazhi) e deri të aksesoret, duhet të jenë testuar rigorozisht kundër shumë kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstilet e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit.

Nëse një artikull tekstili mban etiketën OEKO-TEX standard 100, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th. çdo fije, buton dhe pajisje të tjera, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

Me qëllim zgjerimin e pjesmarrjes në zbatim të LPP më sipër cituar, është lënë mundësia që përveç certifikimeve të kërkuara, operatorët ekonomikë të paraqesin edhe dokumenta të tjera të pranohen raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, të cilat vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) mostrat e artikujve sipas tabelës;
- b) mostrat e lëndës së parë sipas tabelës;
- c) skedat teknike sipas tabelës
- ç) fletë analizë laboratorike të lëndës së parë sipas tabelës, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë,

të cilat vërtetojnë se artikujt e ofruar janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

-Skedat teknike dhe fletë analizë laboratorike të lëndës së parë, sipas kërkesave në tabelën e mëposhtme, do të paraqiten nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Mostrat e artikujve dhe lëndës së parë dhe fletë analizat do të paraqiten për artikujt si më poshtë:

Nr.	Lista e artikujve mostër	Njësia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
I	Uniformës Punës			
1	Kostum i Uniformës së punës për Femra: - Xhakëtë pune me komça me shqiponjë, - Pantallona, - Fund, - Kapele femra.	Komplet	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.

2	Kostum i Uniformës së punës për Meshkuj: - Xhaketë pune me komça me shqiponjë, - Pantallona, - Kapele meshkuj.	komplet	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
3	Pantallona vere M/F. (Mostër e artikullit vetëm për femra)	Palë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
4	Pantallona dimërore M/F. (Mostër e artikullit vetëm për meshkuj)	palë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
5	Këmishë me mëngë të gjata M/F. (Mostër e artikullit vetëm për meshkuj)	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
6	Këmishë me mëngë të shkurtra M/F. (Mostër e artikullit vetëm për femra)	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
7	Bluzë polo mëngë të shkurtra M/F. (Mostër e artikullit vetëm për femra)	copë	Nje kampion tekstili për secilin tekstil përbërës me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
8	Pulovër me jakë “V” blu e errët M/F. (Mostër e artikullit vetëm për meshkuj)	copë	Nje pjesë tekstili të trikotuar me përmasë 0.5 x 0.5 m,	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
9	Xhuboks (Xhaketon) blu e errët M/F. (Mostër e artikullit vetëm për meshkuj)	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
10	Pelerinë shiu (Poncho).	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas

				standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
11	Rrip pantollonash lëkure. (Mostër për meshkuj dhe femra)	copë		Vetëm mostër për artikullin Skedat teknike
12	Xhup dimri blu e errët/e zezë. (Mostra blu e errët)	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
13	Doreza lekure te zeza.	palë	1 kampion të lëkurës 30 x 30 cm.	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
II	Uniforma Operacionale, Grupit të Sigurisë, Struktures së Posaçme.			
1	Kostum stërvitje RIP-STOP për Policinë e Burgjeve blu e errët, - Xhaketa, - Pantallona, - Kapele sportive.	komplet	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
2	Kostum RIP-STOP për forcat speciale ngjyrë e zezë, - Xhaketa, - Pantallona, - Kapele sportive.	komplet	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
3	Bluza me mëngë të shkurtra blu e errët/e zezë. (Mostra blu e errët)	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
4	Bluza me mëngë të shkurtra Polo blu e errët/e zezë. (Mostra blu e errët)	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
5	Bluza me mëngë të gjata termike blu e errët/e zezë. (Mostra e zezë)	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
6	Pulovër me jakë golf mëngë të gjata.	copë	Nje pjesë tekstili të trikotuar me përmasë 0.5 x 0.5 m	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga

				laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
7	Doreza Luftimi.	copë	-	Skedat teknike të produktit përfundimtar
8	Jelek operacional.	copë		Skedat teknike të produktit përfundimtar
9	Kapuç maskimi .	copë		Skedat teknike të produktit përfundimtar
10	Veshje e brendshme e zezë bluzë dhe tutë e zezë.	komplet	Nje pjesë tekstili të trikotuar me përmasë 0.5 x 0.5 m	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
11	Rrip multifunksional.	copë	Nje kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear	Skedat teknike duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
III	Gradat e mëdha supi.			
1	Grada te medha inspektor.	palë	Një kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear në gjerësinë e tekstilit.	-Skeda teknike të tekstilit duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
2	Grada te medha komisar.	palë		
3	Grada te medha “Drejtues i Lartë”.	palë		
IV	Gradat e vogla gjoksi.			
1	Grada te vogla inspektor.	copë	Një kampion tekstili me përmasë 0.5 m linear në gjerësinë e tekstilit.	-Skeda teknike të tekstilit duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
2	Grada te vogla komisar.	copë		
3	Grada te vogla “Drejtues i Lartë”.	copë		

Mënyra e dorëzimit të mostrave:

Secili prej artikujve të sipërcituar, duhet të dorëzohet nje moster. Mostra duhet të jetë i qepur me fije me ngjyrë të kuqe, Artikujt duhet të kenë të qepur / montuar të gjithë aksesorët, sipas specifikimeve teknike. Kampionet / mostrat duhet të kenë të qepur etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar dhe të jenë me ambalazhim fabrike.

Kampionet / mostrat duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme me numrin rendor përkatës, të fiksuar në artikull dhe të vulosur nga ofertuesi, sipas numrit rendor të tabelave të mësipërme.

Ne lidhje me paraqitjen e mostres se tekstilit, sqarojme se si moster duhet te paraqitet cope nga tekstili i kryesor i veshjes-jo psh astari apo tekstili dytesor. Kjo vlen edhe per flete analizen dhe skeden teknike, te cilat duhet te jene te tekstilit kryesor te veshjes.

Masat e mostrave të artikujve kërkuara si më sipër të jenë të masës L, janë vendosur të tilla me qëllim trajtimin e barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurën e mësipërme.

Duke qenë se disa artikuj janë për të dyja gjinitë (M/F), përzgjedhja e mostrave që do të paraqiten, duke përcaktuar njërën ose tjetrën gjini është bërë në mënyrë rastësore, me qëllim shmangien e konfuzionit të operatorëve ekonomikë gjatë ofertimit. I njëjti arsyetim vlen edhe për përzgjedhjen e artikujve që janë të disponueshëm në dy ngjyra.

Mos dorëzimi i kampioneve / mostrave sipas kërkesave të sipër përmendura përbën kusht për skalifikim.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e mostrave dhe skadat teknike si më sipër është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) **mostra të mallit**, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi dhe të lëndës së parë, të përcaktuara si më sipër, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, llojin e mallit që kërkohet, specifikimet teknike të artikujve dhe aksesorëve që ato përmbajnë, të cilat janë të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi “Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr. 260 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, i ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë së materialit të produktit final, dizenjimin e uniformave, dimensionet e kërkuara, si dhe

karakteristika të tjera që lidhen me aksesoret që kanë këto artikuj, të cilat nuk mund të verifikohen përmes dokumentave të tjerë të kërkuara. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Kërkesa për paraqitjen e fletë analizave të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues”, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2028 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës), nëpërmjet të cilave duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e artikujve që ata ofrojnë me specifikimet teknike të objektit të prokurimit sipas specifikimeve teknike të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi “Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr. 260 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, i ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.

Ky kriter është vendosur, gjithashtu duke iu referuar specifikimeve teknike ku verifikimi i disa elementeve të cilësisë së artikujve mund të verifikohet vetëm nëpërmjet analizave laboratorike për sa i përket lëndës së parë të përdorur për realizimin e produktit final. Fleta e analizës laboratorike garanton që materialet e përdorura për prodhimin e artikujve veshmbathje i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, ku përfshihen lloji i lëndës së parë të përdorur dhe përbërësve të tjerë ndaj forcave mekanike, ujit, kimikateve apo faktorëve të tjerë që ndikojnë në performancën e produktit final. Fletë analizat sigurojnë që produkti përfundimtar do të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim afatgjatë. Siguria e përdoruesve të produktit përfundimtar, është një tjetër faktor që e bën të domosdoshme kërkesën për analiza laboratorike, duke i garantuar ata që produkti është i sigurt dhe mund të ofrojë mbrojtje adekuate daj rreziqeve të caktuara.

Kërkesa për skedë teknike gjithashtu është një kërkesë e domosdoshme për procedurat e mallrave që garanton se malli i ofruar është në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike.

Në këtë kriter është kërkuar që mostra duhet të jetë i qepur me fije me ngjyrë të kuqe me qëllim që artikujt objekt prokurimi të jenë prodhuar enkas për këtë procedurë prokurimi dhe për një trajtim të barabartë për të gjitha operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
-------	-------	---------

Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje
---------------------------------	---------	---------------------------------

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit/(per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerases, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.8 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Referuar shtojcës 7 janë përcaktuar termat e referencës në lidhje me zbatimin e kontratës, ku është përcaktuar se Artikujt e Uniformës dhe të Këpucëve të Policisë së Burgjeve do të magazinohen në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me qendër në Tufinë dhe në Vaqarr. Në rast të ndryshimit të vendit të magazinimit operatori fitues do të njoftohet zyrtarisht, duke i dhënë mundësi operatorit ekonomik të organizohet për të furnizuar artikujt objekt kontrate në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor përfitues.

Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për minimumi 1 mjet është vendosur duke patur në konsideratë vendin e dorëzimit të objektit të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht me e favorshme.

Shënim: Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato

teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim: Bazuar në nenin 82 pika 4 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

Shënim: Bazuar në nenin 14 pika 2 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorezohen vetëm nga operatori ekonomik që është shpallur fitues:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI II: BLERJE KËPUCË PËR POLICINË E BURGJEVE

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme bazohet në Nenin 76 dhe Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar si dhe Neni 25, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit II. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare

konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 2 është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor

duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Në rastin konkret Njësisa e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 2 me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontrates/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit të lotit 2, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të balanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. ”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale

me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit⁴⁵. Nëse kërkojnë bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit II.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të

gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“ . Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme, të cilat duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit 2. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë minimalisht 45 (dyzet e pesë) persona të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- a)** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b)** Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shenim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Specifikimet teknike për artikujt objekt i këtij loti janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi “Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.

Referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të kepuceve të Policisë së Burgjeve, ato janë artikuj të cilat nuk gjenden lirisht në treg, por duhet të prodhohen enkas për këtë procedurë prokurimi.

Nisuar nga sasia, vlera e fondit limit të këtij loti, e cila është një vlerë e konsiderueshme, specifikimet teknike të kepuceve objekt prokurimi kërkohet detyrimisht që operatori ekonomik të provojë se ka punonjës minimalisht 45 për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për 3 muajt e fundit data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata

tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim minimalisht 45 punonjesve duke përfshirë dhe stafin teknik të kërkuar në kriterin nr. 3, që janë specialistë që do të merren drejtpërdrejt me prodhimin e produktit përfundimtar, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e prodhimit të mallrave objekt prokurimi.

Përcaktimi i këtij numri minimal punonjësish për kryerjen e kontratës objekt prokurimi është vendosur në mbështetje të pikës 1 të Nenit 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”*. Pra ky kriter është vendosur në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh vëllimin e mallit, afatet kohore të kontratës dhe nevojat specifike të institucionit për marrjen në dorëzim të uniformave në mënyrë të standartizuar dhe pa vonesa.

Në kuadër të procesit për furnizimin me kepuce të Policisë së Burgjeve kërkesa për një numër punonjësish minimalisht prej 45 punonjës është një kërkesë e arsyeshme dhe propocionale për të garantuar kapacitetin operativ dhe logjistik të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës,

Pajisja e Policisë së Burgjeve me kepuce përvec aspektit të prodhimit dhe garantimit të cilësisë kërkon një proces kompleks që përfshin:

1. Marrjen e masave individuale
2. Prodhimin në seri sipas specifikimeve teknike të miratuara.
3. Linje prodhimi të kepuceve dhe aksesoreve të saj të ngjashme, ku përfashihen reparti i qepjes, reparti i prerjes, reparti i montimit.
4. Kontrollin e cilësisë për çdo seri të prodhuar
5. Ambalazhimin/paketimi dhe shpërndarjen në kohë

Të gjitha këto faza kërkojnë një staf të mjaftueshëm të ndarë në funksione të ndryshme si prodhim, magazinim, menaxhim cilësie, logjistikë dhe administrim. Për këtë arsye përcaktimi i një numri punonjësish minimalisht prej 45 personash garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin e duhur njerëzor për të përballuar volumin dhe dinamikën e punës duke shmangur vonesat ose dështimet në furnizim dhe zbatim kontrate.

Zotërimi i punonjësve të kërkuar në list-pagesa për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është edhe një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Gjithshtu Autoriteti Kontraktor nëpërmjet këtij kriteri kërkon të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit të punësuar dhe njëkohësisht stabilitetin ekonomik në kuptimin e vazhdueshmërisë së kryerjes së pagesave financiare kundrejt personelit.

Nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri synohet të arrihet:

- c) Dëshmimi i kapacitetit teknik dhe profesional duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues kanë punonjës aktivë dhe me eksperiencë për të përmbushur kontratën;
- d) Verifikimi i pagesës së sigurimeve shoqërore dhe tatimore duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues respektojnë detyrimet ligjore ndaj punonjësve. Kërkesë kjo e përcaktuar edhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas së cilës operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në perfundim: Referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të këpucëve të Policisë së Burgjeve, ato janë artikuj të cilat nuk gjenden lirisht në treg, por duhet të gjitha të prodhohen enkas për këtë procedurë prokurimi. Prodhimi i sasive të tilla të këpucëve kërkon fuqi punëtore të konsiderueshme. Njësia e prokurimit ka bërë një analizë të thelluar të specifikimeve teknike dhe sasive të këpucëve të cilat kërkohen të prodhohen për Policinë e burgjeve. Në legjislacionin e vendit tonë nuk ekziston një bazë ligjore apo teknike ku mund të mbështetemi për të vendosur numrin e punonjesve fiks sesa nevojiten për të realizuar një kontratë të tillë, ndryshe nga punimet e ndërtimit psh, për të cilat ekziston një manual dhe një llogaritje bazuar në zërat e punimeve apo orët e punës që nevojiten për një proces të caktuar. Për këtë arsye, LPP i lë kompetencë AK-së që të vendosë kriteret për kualifikim në raport me rëndësinë, vështirësinë, fondin limit apo sasi të mallrave që do të prodhohen apo levrohen. Nga një hulumtim i përgjithshëm i fabrikave të prodhimit të këpucëve vihet re se për këtë objekt veprimtarie ka nevojë për fuqi punëtore në kufijtë e një fabrike, ku qoftë fuqia punëtore qoftë makineritë dhe paisjet janë në numër të konsiderueshëm dhe të domosdoshme për të realizuar prodhimin me shumicë. Bazuar në këto studime empirike, Njësia e Prokurimit propozon se numri minimalisht prej 45 punonjës, është një numër i domosdoshëm, për të krijuar bindjen se këpucët pjesë e uniformave të Policisë së Burgjeve me të gjithë komponentët e tyre do të prodhohen në kohë dhe me cilësi si edhe duke repektuar të gjitha parashikimet e kodit të punës për orët, ditët e punës për punonjësit e prodhuesit.

Gjithashtu, Njësia e Prokurimit, gjykon se është e domosdoshme që kompania të ketë numër punonjësish për një periudhë 3 mujore. Sipas legjislacionit të punës (Kodi i Punës, Neni 150- Periudha e provës, etj) që një marrëdhënie pune të konsiderohet e sukseshme duhet që punëmarrësi të ketë kaluar periudhën e provës 3 mujore. Kjo periudhë shërben që palët të njohin njëri tjetrin në aspektin e punës, nëse janë të përshtatshëm, nëse punëmarrësi është i kënaqur me vëndin e punës dhe çfarë është më e rëndësishme nëse punëdhënësi vlerëson se punëmarrësi është i përshtatshëm dhe mund ta realizojë objektin e kontratës së punës. Për kontrata të tilla publike, me rëndësi për funksionimin dhe buxhetin e shtetit, Njësia e Prokurimit vlerëson se një fuqi punëtore e konsoliduar vërtetohet vetëm me këto numër punonjësish në listëpagesat e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës. Për arsye të pjesëmarrjes së kësaj procedurë prokurimi, operatori ekonomik mund të punësojë numrin e kërkuar të punonjësve për muajin e fundit, por pa kaluar periudha e

provës, ky numër nuk është i saktë dhe nuk krijon bindjen që plotësohet. Punonjësit e punësuar rishtaz për këtë kontratë, nuk krijojnë siguri se janë të aftë dhe të gatshëm ta vazhdojnë marrëdhënien e punës, duke krijuar risk për zbatimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit, si njohese e Legjislacionit të prokurimeve Publike, gjykon se edhe nëse një operator ekonomik nuk e plotëson vetë numrin e kërkuar të punonjësve ligji lejon pjesëmarrjen në formën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik si dhe mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera për këtë kriter nuk është e ndaluar.

3. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimi duhet të ketë staf teknik me kualifikimet si më poshtë, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kimist	1
2	Stilist/Modelist këpucësh	1
3	Pergjegjes prodhimi/drejtues linje	2
4	Prestar lëkure/teknik prestarie	2
5	Punonjes për montimin e kepuceve	2
6	Punonjës makinerish qepjen e kepuceve	30
7	Punonjës paketimi	2
8	Punonjës për llustimi/lyerje të këpucëve	2
9	Shofer	1
10	Punonjes për shpërndarjen	2

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për kimistin të paraqitet:

- Diplomën, që të vërteton kualifikimin profesional të mësipërm.
- Kontrate pune e vlefshme
- Kimisti duhet të kenë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

b) Për Stilist/modelist këpucësh, prestar lëkure/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje te paraqitet:

- Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional
- Kontrate pune e vlefshme.
- Stilist/modelist këpucësh, prestar lëkure/teknik prestarie dhe pergjegjes prodhimi/drejtues linje duhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

c) Për Punonjës makinerish/ punonjes për qepjen dhe montimin e kepuceve te paraqitet:

- Kontrate pune e vlefshme.
- Këta punonjësduhet të kenë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune në këtë profesion, vërtetuar me librezë pune ose cdo dokument tjetër të barazvlefshëm.

c) Për punonjës paketimi të paraqitet:

- Kontrate pune e vlefshme

d) Punonjës për llustim/lyerje të këpucëve të paraqitet:

- Kontrate pune e vlefshme

dh) Për punonjësit për shpërndarje, të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme.

f) Për punonjësit shofer të paraqitet:

- Leje drejtimi mjete e vlefshme.
- Kontrate pune e vlefshme.

Shënim: Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Referuar sasisë dhe specifikimeve teknike të këpucëve, pjesë e uniformave të Policisë së Burgjeve, ato janë artikuj të cilat nuk gjenden lirisht në treg, por duhet të prodhohen enkas për këtë procedurë prokurimi dhe detyrimisht operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë staf teknik të kualifikuar, sipas kërkesave të mësipërme, për realizimin e kontratës në përputhje me specifikimet teknike të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi “Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.. Nisur nga lloji i artikujve objekt prokurimi dhe specifikimet teknike të tyre, është kërkuar që një pjesë e stafit teknik të ketë eksperiencë pune minimale një ose dy vite në profilin përkatës siç është kërkuar në kriterin e mësipërm, me qëllim realizimin dhe përmbushjen e kërkesave specifike të kërkuara në specifikimet teknike për këtë objekt prokurimi. Autoriteti kontraktor përfituesi / konsumatori fundor i kësaj procedure është specifik, pasi bëhet fjalë për uniforma, aksesore dhe shenja dalluese të posaçme dhe jo për veshmbathje për përdorim të përgjithshëm.

Kriteri i përcaktuar më sipër, lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një operator ekonomik i cili nuk bind/garanton autoritetin kontraktor se me eksperiencën e tij mund të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi. Ky risk që shfaqet nga mungesa e kapaciteteve teknike është në disa drejtime si, kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e furnizimit brenda afateve kohore të parashikuara apo humbjet që mund të pësojë në kohë, nga moskryerja e furnizimit, gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik për shkak të paafëtisë së tij, mungesës së stafit/punëtorëve apo mungesës së eksperiencës në furnizime mallrash të ngjashme. Gjithashtu, theksojmë, se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga mungesa e eksperiencës dhe kapaciteteve teknike të operatorëve ekonomikë.

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale lëshohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Referuar Vendimit Nr. 514, datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR” përcaktohet:

Grupi-njësi (Profesioni)

“Kimistë”

Kodi i profesionit: 2113

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Kimistë”, niveli i katërt i kompetencës në LKP. Kimisti/ja bën kërkime, hulumtime dhe analiza në mbështetje të operacioneve të prodhimit industrial, proceseve të zhvillimit, kontrollit të cilësisë, kontrollit mjedisor, diagnostikimit dhe trajtimit mjekësor, bioteknologjisë, aplikimin e qasjeve të reja teorike, në lidhje me kiminë, për të zhvilluar produkte të reja. Ai/Ajo kryen eksperimente, teste dhe analiza për të hetuar mbi përbërjen kimike, energjinë dhe ndryshimet kimike në substanca, materiale apo produkte të ndryshme natyrale ose sintetike, për mbledhjen dhe analizimin e mostrave dhe të dhënave për të identifikuar dhe llogaritur sasinë e toksikantëve në mjedis, duke bashkëpunuar me inxhinierë kimie, biologë, mikrobiologë, agronomë, gjeologë ose profesionistë të tjerë.

Ai/Ajo mund të punësohet në institucione apo në laboratorë kërkimore, të zhvillimit dhe kontrollit të cilësisë, në laboratorë kimikë, petrokimikë dhe të industrisë farmaceutike e minerale, në institucione të shërbimeve shëndetësore, arsimore që ofrojnë shërbime të fushën kimisë apo të vetë-punësohet.

Funksionet kryesore

Kimistët kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Kryejnë kërkime për përmirësimin ose zhvillimin e koncepteve, mjeteve, teorive dhe metodave operative që lidhen me kiminë;*
- b) Kryejnë eksperimente, teste dhe analiza për të hetuar mbi përbërjen kimike, energjinë dhe ndryshimet kimike në substanca, materiale apo produkte të ndryshme natyrale ose sintetike;*
- c) Zhvillojnë procedura për kontrollin e mjedisit, kontrollin e cilësisë dhe procedura të tjera të ndryshme për prodhuesit ose përdoruesit;*
- d) Kryejnë programe për mbledhjen dhe analizimin e mostrave dhe të dhënave për të identifikuar dhe llogaritur sasinë e toksikantëve të mjedisit;*
- e) Marrin pjesë në projekte ndërdisiplinore për kërkim dhe zhvillim duke punuar me inxhinierë kimie, biologë, mikrobiologë, agronomë, gjeologë ose profesionistë të tjerë;*
- f) Kryejnë kërkime mbi aspekte kimike të mekanizmave, të veprimit të medikamenteve në diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve, mbi funksionin e organeve dhe vlerësimin e shëndetit;*
- g) Përdorin mikro-organizma në përbërje të substancave për të konvertuar ato në substanca të reja;*
- h) Përcaktojnë mënyra dhe procedura për të kryer forcime, përqendrime, kombinime ose për të zhvilluar materiale të reja.*
- i) Riprodhojnë dhe sintetizojnë substancat, lëndët natyrale;*
- j) Vlerësojnë procedurat e sigurisë së laboratorit për të siguruar dhe kryejnë përmirësimet e nevojshme pajtueshmërinë me standardet;*
- k) Kryejnë testime dhe analizojnë rezultatet e testimeve për të përcaktuar eficiencën ose për të diagnostikuar keqfunksionimin e proceseve ose pajisjeve;*
- l) Kryejnë teste të kontrollit të cilësisë;*
- m) Mirëmbajnë instrumentet laboratorike;*

- n) Përgatitin artikuj, raporte shkencore apo materiale të tjera statistikore;
- o) Ofrojnë konsulencë teknike në fusha të veçanta të ekspertizës;
- p) Kryejnë arkivimin, kopjimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, në formatin fizik dhe elektronik;
- q) Komunikojnë me profesionalizëm me eprorë, kolegë dhe të tjerë;
- r) Mbikëqyrin punën e punëtorëve mbështetës dhe personelit tjetër të zyrës;
- s) Respektojnë politikat e brendshme dhe procedurat e hartuara nga organizata;
- t) Zbatojnë rregullat e sigurimit në punë dhe të mbrojtjes së shëndetit;

Kërkesat për punësim

a. Kërkohet të ketë diplomë universitare

b. Të jetë i aftë mendërisht.

Informacion shtesë

Kualifikimet pasuniversitare përbëjnë avantazh në punësim dhe zhvillim karriere.

Një individ mund të hyjë në profesion si asistent. Me eksperiencë dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin specialistit të kimisë. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm me studime të thelluara apo trajnimit nëpërmjet punës, një kimist mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse në fushën e shërbimeve kimike.

Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik sipas rastit licenca profesionale e ushtrimit të profesionit.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: kimist, kimist në industrinë farmaceutike, kimist në metalurgji, kimist specialist i korrozioneve, kimist specialist në kiminë analitike, në kiminë minerare, në kiminë nukleare, në kiminë organike, kimist specialist për naftën, plastikën, kimist specialist për produktet ushqimore, kimist, kontrollor cilësie.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

2113.01 Kimist

2113.02 Kimist në industrinë farmaceutike

2113.03 Kimist në kristalografi

2113.04 Kimist në metalurgji

2113.05 Kimist specialist i korrozioneve

2113.06 Kimist specialist në kiminë analitike

2113.07 Kimist specialist në kiminë fizike

2113.08 Kimist specialist në kiminë inorganike

2113.09 Kimist specialist në kiminë minerare

2113.10 Kimist specialist në kiminë nukleare

2113.11 Kimist specialist në kiminë organike

2113.12 Kimist specialist në prodhimin e qelqit

2113.13 Kimist specialist në tekstil

2113.14 Kimist specialist për bojëra

2113.15 Kimist specialist për detergjentet

2113.16 Kimist specialist për kauçukun

2113.17 Kimist specialist për materialet plastike
 2113.18 Kimist specialist për naftën
 2113.19 Kimist specialist për ngjyrat
 2113.20 Kimist specialist për parfume
2113.21 Kimist specialist për përpunimin e lëkurës
 2113.22 Kimist specialist për polimerët
 2113.23 Kimist specialist për produktet ushqimore
2113.24 Kimist, kontrollor cilësie
 2113.25 Farmakolog
 2113.26 Farmakolog në toksikologji
 2113.27 Biokimist
 2113.28 Kimist laborant

Shembuj të profesioneve/punësimeve të ngjashëm që klasifikohen në nivele të ndryshme të kompetencës në Listën Kombëtare të Profesioneve:

<u>2145</u>	<u>Inxhinierë kimistë</u>
3116.01	Inspektor sigurimi kimik
2310.21	Pedagog kimist
2310.43	Pedagog në inxhinieri kimike
2131	Biologë, botanistë dhe profesione të ngjashme
2262	Farmacistë
3111	Teknikë të shkencës së kimisë dhe fizikës
3116	Teknikë të inxhinierisë kimike
3134	Kontrollorë të procesit të përpunimit kimik
2113.27	Biokimist
2131.33	Farmakolog
2262	Farmacistë

Grupi-njësi (Profesioni)

“Inxhinierë kimistë”

Kodi i profesionit: 2145

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Inxhinierë kimistë”, niveli i katërt i kompetencës në LKP.

Inxhinierët kimike kryejnë kërkime dhe zhvillojnë, këshillojnë ose drejtojnë proceset kimike komerciale dhe prodhimin e një sërë substancash dhe produktesh të tilla si: nafta bruto, derivatet e naftës, produktet ushqimore dhe pijet, ilaçet apo materialet sintetike. Ata drejtojnë mirëmbajtjen dhe riparojnë impiantet dhe pajisjet kimike dhe studiojnë e këshillojnë mbi aspektet kimike të materialeve, produkteve apo proceseve të veçanta.

Funksionet kryesore

Inxhinierët kimike kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Kryejnë studime dhe këshillojnë, e zhvillojnë procese kimike të shkallës komerciale për të përpunuar naftën bruto dhe lëndët e tjera të lëngshme apo të gazta, si dhe për të prodhuar substanca dhe produkte të tilla si: derivatet e karburantit, eksplozive, produkte ushqimore dhe pije, ilaçe apo materiale sintetike;
- b) Specifikojnë metodat e prodhimit kimik, materialet dhe standardet e cilësisë, si dhe sigurojnë që ato të jenë konform specifikimeve teknike;
- c) Krijojnë standarde dhe procedura kontrolli për të garantuar sigurinë dhe eficiencën e operacioneve të prodhimit të kimikateve dhe sigurinë në punë të punëtorëve;
- d) Dizajnojnë pajisjet e impianteve kimike dhe hartimin e proceseve për prodhimin e kimikateve dhe produkteve;
- e) Kryejnë teste gjatë fazës së prodhimit për të përcaktuar nivelin e kontrollit mbi ndryshimet që hasen, përfshi temperaturën, dendësinë, gravitetin specifik dhe presionin;
- f) Zhvillojnë procedura të sigurisë së shëndetit në punë;
- g) Përgatisin llogaritjet e kostove të prodhimit dhe progres raportin e produkteve për personelin manaxhues;
- h) Kryejnë studime laboratorike të hapave në prodhimin e produkteve të reja dhe testojnë proceset e propozuara në shkallë të vogël, të tilla si impiante pilot;
- i) Mbikëqyrin dhe drejtojnë punën e personelit;
- j) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- k) Rritin aftësitë e veta profesionale.

Kërkesat për punësim

- a. Arsim i Larte, preferohet Inxhinieri Kimike;
- b. Aftësi analitike dhe komunikuese;
- c. Preferohen specializime dhe kualifikime të vazhdueshme.

Informacion shtesë

Një individ mund të nisë punë si teknik i inxhinierisë kimike, apo si kontrollor i procesit kimik duke pasur vetëm arsim para universitar. Me pas kryerjen e arsimit të lartë, në Inxhinieri Kimike dhe kurse kualifikuese mund të punësohet si inxhinier kimik. Inxhinieri Kimik mund të punësohet në sektorë të ndryshëm, të karburanteve, letrës, plastikës, artikujve ushqimore e pijeve etj. Kualifikimet pasuniversitare përbëjnë avantazh në punësim dhe zhvillim karriere.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 2145.01 Inxhinier/teknolog në fabrikë
- 2145.02 Inxhinier/teknolog në fabrikë birre
- 2145.03 Inxhinier/teknolog në fabrikimin e pneumatikëve
- 2145.04 Inxhinier/teknolog për artikujt ushqimor dhe pije
- 2145.05 Inxhinier/teknolog për bojërat
- 2145.06 Inxhinier/teknolog për fibrat artificiale dhe sintetike
- 2145.07 Inxhinier/teknolog për karburantet
- 2145.08 Inxhinier/teknolog për kauçukun

2145.09 Inxhinier/teknolog për letrën
 2145.10 Inxhinier/teknolog për materiale plastike
 2145.11 Inxhinier/teknolog për naftë dhe gaz natyral
 2145.12 Inxhinier/teknolog për polimerët
 2145.13 Inxhinier kimist
 2145.14 Inxhinier kimist në fabrikë
 2145.15 Inxhinier kimist në filaturë
 2145.16 Inxhinier kimist për artikuj ushqimor dhe pije
 2145.17 Inxhinier kimist për letrën
 2145.18 Inxhinier kimist për materiale plastike
 2145.19 Inxhinier kimist për naftë dhe gaz natyral
 2145.20 Inxhinier kimist specialist gazi
 2145.21 Inxhinier kimist/specialist për karburantet
 2145.22 Inxhinier kimist/specialist për kauçukun
 2145.23 Inxhinier kimist/specialist për ngjyrat dhe bojërat
 2145.24 Inxhinier i proceseve të rafinimit
 2145.25 Inxhinier kimist/specialist për materiale ndërtimi

Shembuj të profesioneve/punësimeve të ngjashëm që klasifikohen në nivele të ndryshme të kompetencës në Listën Kombëtare të Profesioneve:

3111 Teknikë të shkencës së kimisë dhe fizikës
 3116 Teknikë të inxhinierisë kimike
 3134 Kontrollorë të procesit të përpunimit kimik

Referuar Vendimit Nr. 514, datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR” përcaktohet:

“Punonjës të tekstileve, të lëkurës, veshjeve dhe të ngjashme me to”

Kodi i profesionit: 753

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punonjës të tekstileve, të lëkurës, veshjeve dhe të ngjashme me to”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Punonjësit e punimeve të tekstilit, lëkurës dhe materialeve të tjera të ngjashme përgatisin fibrat natyrale të tekstilit, fijen e leshit nëpërmjet endjes, thurjes dhe mënyrave të tjera, kryejnë punimin, riparimin dhe përshtatjen e veshjeve me materiale të ndryshme tekstili, si dhe përpunojnë e përgatisin lëkurën dhe gëzofin për veshje apo artikuj të tjerë lëkure natyrale apo sintetike. Ata mund të punësohen në kompani të punimeve të tekstilit, lëkurës dhe materialeve të tjera të ngjashme apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore:

Punonjës të tekstileve, të lëkurës, veshjeve dhe të ngjashme me to kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Përgatitin fije tekstili, leshi, pambuku, liri, kërpi, fibra natyrale të tekstilit;*
- b) Prodhojnë stofra, pëlhura me endje, thurje dhe teknika të tjera;*

- c) Përgatisin veshje sipas modeleve dhe kërkesës së klientit;
- d) Bëjnë qëndisje dhe dekorime me dorë ose me makinë;
- e) Bëjnë prerje të materialeve të ndryshme të tekstilit;
- f) Bëjnë qepjen e ndryshme të materialeve tekstile;
- g) Bëjnë qepje dhe punime tapicerie;
- h) Bëjnë përpunimin e lëkurës dhe gëzofit për veshje apo artikuj të tjerë;
- i) Përgatitin dhe riparojnë këpucë, si dhe bëjnë punime galanterie për artikuj të tjerë lëkure;
- j) Bëjnë preventiv për shërbimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit;
- k) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;
- l) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

- a) Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion.
- b) Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një punonjës tekstili, lëkure, veshje dhe të ngjashme me to mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel tekniku. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivel inxhinier.

Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e tekstilit, lëkurës, veshjeve dhe të ngjashme me to duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Profesionet, “Operatorët dhe montuesit e pajisjeve dhe makinave të përpunimit të tekstilit e lëkurës” që kërkojnë përvojë dhe njohuri të veçanta, klasifikohen në Grupin Kryesor 8.

Profesionet elementare të natyrës së thjeshtë dhe rutinë, që përfshijnë punën me vegla të dorës dhe pak përpjekje fizike, me pak ose aspak përvojë dhe njohuri paraprake për punën klasifikohen në Grupin Kryesor 9.

Profesionet që klasifikohen në këtë grup profesione, në Listën Kombëtare të Profesioneve janë:

- 7531 Rrobaqepës (fustane, kapele, gëzof etj.)
- 7532 Modelistë, prestarë dhe punonjës të tjerë të ngjashëm
- 7533 Punëtorë qepës të tjerë
- 7534 Qëndistarë
- 7535 Tapicierë dhe të tjerë që lidhen me to
- 7536 Lëkurëpunues, regjës të lëkurës, përpunues të gëzofit dhe të ngjashëm
- 7537 Prodhues të këpucëve dhe galanteria

Grupi-njësi (Profesioni)

“Prodhues të këpucëve dhe galanterie”

Kodi i profesionit: 7537

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Prodhues të këpucëve dhe galanteria”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Prodhuesi i këpucëve dhe galanterisë punon dhe prodhon me porosi këpucë standarde ose ortopedike dhe artikuj të tjerë lëkure natyrore ose sintetike si valixhe, çanta, rripa, pajimet për kafshët etj. (me përjashtim veshje lëkure, kapele dhe dorashka)apo merr pjesë në prodhimin e këpucëve apo artikujve të ngjashëm. Ai riparon, dekoron, zbukuron, përforcon apo përfundon këta artikuj. Ai mund të punësohet në kompani shërbimesh apo prodhimesh të artikujve prej lëkure apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore:

Prodhuesit e këpucëve dhe galanterisë kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Konsultohen me klientët për porositë e marra si për modelin dhe materialin e duhur të artikullit të kërkuar;*
- b) Bëjnë modelimin e porosisë së klientit;*
- c) Bëjnë llogaritjen e kostos së porosisë së marrë;*
- d) Sigurojnë bazën materiale (lëkurën, astarin, tabanët, shojet, lidhëset, aksesorët shtesë etj.)*
- e) Skicojnë modelin ose konsultojnë modelin e kërkuar;*
- f) Përzgjedhin thikat prerëse (stampat) për modelin e kërkuar;*
- g) Bëjnë prerjen e detaleve të lëkurës në përputhje me modelin e kërkuar;*
- h) Bëjnë prerjen e astarëve me material lëkure dhe /ose lëkura sintetike;*
- i) Kryejnë procesin e skajimit të detaleve me makineri ose me dorë;*
- j) Bëjnë përgatitjen e makinave të punës për qepje;*
- k) Bëjnë përzgjedhjen e fijeve të duhura;*
- l) Bëjnë qepjen e detaleve sipas radhës së duhur;*
- m) Përgatitin kallëpin në tabanë;*
- n) Kryejnë montimin e këpucës me dorë ose me makineri;*
- o) Kryejnë montimin e syprinës me tabanin (kallëpin);*
- p) Bëjnë smerilimin e këpucës (heqin cipën e lëkurës);*
- q) Kryejnë lyerjen me mastiç (ngjitës) të këpucës;*
- r) Bëjnë procesin e ngjitjes me makineri;*
- s) Heqin këpucën nga kallëpi;*
- t) Vendosin aksesorë të ndryshëm kur është e nevojshme;*
- u) Bëjnë punimet e duhura me dorë;*
- v) Bëjnë pastrimin e fijeve të qepjes;*
- ë) Kryejnë lyerjen me bojë dhe lustrimin e artikullit të prodhuar;*
- x) Bëjnë kontrollin përfundimtar të porosisë;*
- y) Bëjnë paketimin e artikullit të porositur;*
- z) Bëjnë riparime të ndryshme në artikuj lëkure sipas kërkesës së klientit;*
- aa) Punojnë dhe riparojnë artikuj lëkure si; valixhe, çanta, rripa, shalë dhe pajimet për kafshët apo pajisje të tjera;*

- bb) Bëjnë modifikime dhe riparime këpucësh ortopedike ose terapeutik në bazë të recetës mjekësore ose modifikojnë këpucë ekzistuese për njerëzit me probleme në këmbë dhe nevoja të veçanta;
- cc) Kontrollonjë ngjyrën, cilësinë dhe fortësinë e lëkurës për të siguruar se ajo është e përshtatshme për një qëllim të caktuar;
- dd) Bëjnë zbukurime apo dekorime të produkteve sipas porosisë apo modelit;
- ee) Realizojnë detyra të ngjashme;
- ff) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;
- gg) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

- a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional në këtë fushë.
- b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një prodhues i këpucëve dhe galanterisë mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel mbikëqyrësi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier.

Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e këpucarisë dhe galanterisë duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: këpucar bërës këpucësh, bërës pajime për kafshë, riparues këpucësh, prestar lëkurësh bërës artikujsh lëkure etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 7537.01 Bërës kallëpi këpucësh
- 7537.02 Bërës kamxhikësh
- 7537.03 Bërës këpucë për kirurgjinë
- 7537.04 Bërës këpucësh
- 7537.05 Bërës këpucësh me porosi
- 7537.06 Bërës këpucësh me thupra
- 7537.07 Bërës këpucësh ortopedike
- 7537.08 Bërës këpucësh sportive
- 7537.09 Bërës mallrash lëkure
- 7537.10 Bërës pajime kali
- 7537.11 Bërës pajime sportive
- 7537.12 Bërës qafore kali
- 7537.13 Bërës samarë dërrase
- 7537.14 Bërës shale

7537.15 Bërës shtroje këpucësh
 7537.16 Bërës vrimash në këpucë
 7537.17 Forcues i këpucëve
 7537.18 Këpucar
 7537.19 Klasifikues gjysmash këpucësh
 7537.20 Lëmim i këpucëve të përfunduara
7537.21 Lustrues këpucësh
7537.22 Lustrues takash
 7537.23 Mbështjellës këpucësh syprinash
 7537.24 Mjeshtër këpucësh
7537.25 Modelist këpucësh
 7537.26 Montues gjysma këpucësh
 7537.27 Montues syprinash këpucësh
 7537.28 Ndarës këpucësh sipas cilësisë
 7537.29 Ngjyrues këpucësh
 7537.30 Përgatitës dhe hedhës gjysmash këpucësh
 7537.31 Përgatitës syprinash këpucësh
 7537.32 Përkulës këpucësh
 7537.33 Pranues i këpucëve të përfunduar
7537.34 Prestar këpucësh
7537.35 Prestar lëkurësh
 7537.36 Riparues këpucësh
 7537.37 Shtypës gjysmash këpucësh
 7537.38 Zbërthyes këpucësh
 7537.39 Vendosës aksesorësh të ndryshëm në produkte lëkure
 7537.40 Bërës punimesh dore në produkte lëkure
 7537.41 Paketues i produkteve të lëkurës
 7537.42 Punues dhe riparues i artikujve të lëkurës (valixhe, çanta, rripa apo pajisje të tjera)
 7537.43 Smerilues i këpucëve (heqje e cipës së lëkurës)
 7537.44 Bërës punimesh ngjitjeje me mastiç të këpucëve
 7537.45 Bërës punimesh skajimi të detaleve të lëkurës (me makineri ose me dorë)
 7537.46 Ndhmës modelist këpucësh
 7537.47 Modelist të produkteve të galanterisë

Shembuj të profesioneve/punësimeve të ngjashme që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

3122.05	<u>Përgjegjës prodhimi për përpunimin e lëkurës</u>
6122.16	Trajtues paraprak i lëkurës
7319/1.25	Punëtor artizan për lëkurë
7536	Lëkurëpunues, regjës të lëkurës, përpunues të gëzofit dhe të ngjashëm
7536.10	Ngjyrues lëkurësh
8156	Punëtorë të makinave të prodhimit të këpucëve dhe galanterisë
8156.01	Makinist për prodhim këpucësh

Grupi-njësi (Profesioni)

“Përgjegjës prodhimi”

Kodi i profesionit: 3122

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Përgjegjës prodhimi”, niveli i tretë i kompetencës në LKP.

Përgjegjësi i prodhimit siguron mbarëvajtjen e të gjithë procesit të prodhimit deri në produktin përfundimtar, sipas kërkesave të klientit. Ai planifikon, organizon, mbikëqyr dhe kontrollon punën e përditshme në lidhje me planet e prodhimit, personelit, pajisjet e makineritë, bazën materiale, llogaritjen e kostos apo kohës së punës etj., përdor dhe përgatit dokumentacion teknik, përgatit raporte të ndryshme apo dokumente të tjera dhe bashkëpunon me punëtorët, kontrollorët e cilësisë apo dhe drejtues të tjerë të prodhimit. Përgjegjësi i prodhimit orienton, udhëzon apo trajnon personelin për procese të ndryshme pune gjatë prodhimit. Ai mund të punësohet në kompani të shërbimeve të prodhimi apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore

Përgjegjësit e prodhimit kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Planifikojnë punën e përditshme në lidhje me planet e prodhimit, personelit, pajisjet e makineritë, bazën materiale etj.;*
- b) Organizojnë punën e përditshme në përputhje me planifikimet e bëra dhe teknologjitë përkatëse të prodhimit;*
- c) Kryejnë punë parapërgatitore për proceset e prodhimit (p.sh. përgatitje shablloni etj.);*
- d) Organizojnë proceset e prodhimit duke identifikuar hapat dhe burimet e nevojshme për zhvillimin e procesit të prodhimit;*
- e) Përcaktojnë planin e prodhimit dhe hapat përkatëse të procesit të prodhimit;*
- f) Përzgjedhin makineritë dhe pajisjet e duhura për proceset e ndryshme të punës;*
- g) Llogaritin kohën për çdo proces të prodhimit;*
- h) Përgatitin raporte të vlerësimit të kostos dhe të dhënat e tjera;*
- i) Kryejnë ndarjen e punës për çdo punonjës;*
- j) Identifikojnë mungesën e personelit ose të komponentëve dhe marrin masat e duhura në raste të tilla;*
- k) Orientojnë dhe udhëzojnë personelin për procese të ndryshme pune gjatë prodhimit;*
- l) Kryejnë trajnimin e personelit të ri;*
- m) Bashkërendojnë dhe mbikëqyrin veprimtarinë teknike të procesit të kontrollit;*
- n) Bashkërendojnë dhe mbikëqyrin mirëfunksionimin e makinerive dhe pajisjeve të prodhimit;*
- o) Mbikëqyrin ecurinë e procesit të prodhimit duke kërkuar zbatimin e standardit të cilësisë;*
- p) Ndërhyjnë e zgjidhin problemet që dalin gjatë procesit të prodhimit;*
- q) Përdorin dhe përgatitin dokumentacionin teknik apo dokumente të tjera;*
- r) Realizojnë detyra të tjera të ngjashme;*
- s) Komunikojnë me eprorët dhe vartësit në mënyrë profesionale;*
- t) Bashkëpunojnë me të tjerët;*
- u) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;*

- v) Identifikojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- ë) Respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- x) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së shëndetit në punë ;
- y) Zbatojnë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

Kërkesat për punësim

- a. Zakonisht kërkohet përfundimi i studimeve bachelor ose një shkolle profesionale në këtë fushë:
- b. Preferohet të ketë 2 vjet përvojë të mëparshme në fazat ndryshme të prodhimit;
- c. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

- a. Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës. Me eksperiencë dhe me kualifikim të mëtijshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një përgjegjës prodhimi mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel drejtues prodhimi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit në fushat përkatëse të prodhimit.
- b. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.
- c. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme të tilla si: Përgjegjës për përpunimin e konfeksioneve, përgjegjës për përpunimin e lëkurës, përgjegjës për përpunimin e letrës, përgjegjës për përpunimin e metaleve, përgjegjës për përpunimin e plastikës, përgjegjës për përpunimin e tekstileve, përgjegjës për përpunimin të produkteve ushqimore etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 3122.01 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e dheut
- 3122.02 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit
- 3122.03 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e kablllove elektrike.
- 3122.04 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e konfeksioneve
- 3122.05 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e lëkurës
- 3122.06 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e leshit
- 3122.07 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e letrës
- 3122.08 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e metaleve
- 3122.09 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e plastikës
- 3122.10 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e produkteve të gomës
- 3122.11 Përgjegjës prodhimi për përpunimin e tekstileve
- 3122.12 Përgjegjës prodhimi për përpunimin të produkteve ushqimore
- 3122.13 Përgjegjës sektori në prodhim
- 3122.14 Përgjegjës turni në prodhim industrial
- 3122.15 Përgjegjës turni
- 3122.16 Brigadier në prodhim
- 3122.17 Kontrollues i cilësisë së prodhimit në tekstil-konfeksione
- 3122.18 Kontrollues i cilësisë së prodhimeve të lëkurës

3122.19 Kontrollues i cilësisë së prodhimit në industrinë ushqimore

3122.20 Kontrollues i cilësisë së prodhimi

Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh” Kodi i profesionit: 8322

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Shoferi i makinave, taksive dhe furgonave merret me transportin e udhëtarëve, mallrave, postës, etj. Ai drejton mjetet motorike duke u kujdesur për një transport të sigurt dhe të përshtatshëm duke zbatuar rregullat e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Ai mund të punësohet në kompani shërbimesh të ndryshme, shërbimesh transporti apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore Shoferët e makinave, taksive dhe furgonave kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kontrollonjë mjetin motorik para fillimit të punës; b) Drejtojnë mjetet motorike për të transportuar udhëtarë, mallra, postën etj; c) Kujdesen për transportimin sigurt të mallrave dhe udhëtarëve; d) Ndihmojnë pasagjerët për bagazhet e tyre; e) Kontrollonjë çmimet dhe pagesat për dërgesat ose dokumente që vërtetojnë dërgesat dhe grumbullojnë pagesat përkatëse; f) Përdorin pajisjet operative të telekomunikacionit për të raportuar vendndodhjen dhe disponueshmërinë e tyre; g) Ndjekin udhëzimet e kontrollit të qendrës së shoqërisë së transportit; h) Përcaktojnë rrugën më të përshtatshme për të arritur në destinacion; i) Ndihmojnë pasagjerët me aftësi të kufizuara fizike, në lëvizjet e tyre; j) Përdorin pajisje për të lehtësuar ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave apo lëvizjen e udhëtarëve me aftësi të kufizuara fizike; k) Zbatojnë rregulloren e transportit rrugor për mallra dhe udhëtarë; l) Kryejnë shërbime të mirëmbajtjes periodike të mjetit motorik; m) Bëjnë llogaritjet dhe plotësimin e faturës përkatëse për punën e kryer; n) Pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetin e punës dhe e lënë atë në gjendje të gatshme për punë; o) Realizojnë detyra të ngjashme; p) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; q) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit të kërkuar nga organet përkatëse. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkollë profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë fushë përbën avantazh. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një drejtues i makinave, furgonëve dhe motoçikletave mund të ndër marrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel mbikëqyrësi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier mekanik. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e transportit duhet leje drejtimi për mjetin përkatës dhe regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: shofer ambulance, shofer kamionçine, shofer taksie, shoferë furgonësh etj.

“Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport”

Kodi i profesionit: 93

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport”, niveli i parë i kompetencës në LKP. Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë detyra të thjeshta dhe rutinë, në miniera, gurore, ndërtimit, prodhimit, punë transporti, magazinimi, seleksionimi dhe paketimi, duke punuar me krahë, makineri dhe pajisje të pa motorizuara, apo karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshë. Ata kryejnë shërbime ndihmëse, kryesisht punë që kërkojnë aftësi fizike dhe pak njohuri. Ata mund të punësohen në kompani të punimeve dhe shërbimeve të ndryshme, apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore: Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kryejnë punë krahu dhe mirëmbajnë guroret; b) Kryejnë punë krahu dhe mirëmbajnë miniera; c) Kryejnë punë krahu dhe mirëmbajnë hekurudha; d) Kryejnë punë krahu dhe mirëmbajnë diga; e) Kryejnë punë krahu në ndërtim dhe mirëmbajtje rrugësh; f) Kryejnë gjurmime dhe heqje dheu me lopatë, duke përdorur mjete dore apo pajisje të thjeshta; g) Kryejnë hapje të kanaleve, puseve të ujit; h) Kryejnë shembje të ndërtimeve me pajisje dore; i) Kryejnë punë krahu në ndërtim; j) Kryejnë mirëmbajtje të ndërtesave të ndryshme; k) Bëjnë mbushje të kontejnerëve dhe raftëve me produktet e duhura; l) Kryejnë punë krahu në industri të ndryshme; m) Kryejnë ambalazhime të ndryshme me dorë; n) Seleksionojnë materiale të ndryshme në vendet e grumbullimit të tyre; o) Ndezin zjarr dhe ndihmojnë në impiante të ngrohjes së ujit; p) Punojnë me karroca dhe pajisje të tjera të pa motorizuara për ngarkim-shkarkim mallrash të ndryshme; q) Drejtojnë dhe punojnë me karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshët; r) Ngarkojnë dhe shkarkojnë materiale ndërtimi; s) Ngarkojnë dhe shkarkojnë mallra të ndryshme në anije, në avion, në kamionë, në pajisjet frigoriferike, apo magazina të ndryshme etj; t) Sistemojnë dhe paketojnë mall për transport; u) Realizojnë detyra të ngjashme; v) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; w) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i arsimit të detyruar.

b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

“Punëtorë ngarkim-shkarkimi”

Kodi i profesionit: 9333

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë ngarkim-shkarkimi”, niveli i parë i kompetencës në LKP.

Punëtori ngarkim-shkarkimi zhvendos, ngarkon dhe shkarkon mallra të ndryshme, me krahë dhe pajisje të thjeshta. Ai gjithashtu mbart, ngarkon dhe shkarkon mobilie dhe të sendeve të tjera të

ngjashme shtëpiake. Ai ngarkon dhe shkarkon mallra prej anijeve, avionëve, vagonëve si edhe në magazina të ndryshme.

Funksionet kryesore Punëtorët e ngarkim-shkarkimit kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Paketojnë orendi shtëpiake apo mobilie zyrash, pajisje dhe mallra të tjera të ngjashme të cilat duhet të transportohen nga një vend në tjetrin;
- b) Transportojnë mallra për t'u ngarkuar ose shkarkuar nga furgonë, kamionë, vagonë, anije, apo avionë;
- c) Ngarkojnë dhe shkarkojnë drithëra, qymyr, rërë dhe mallra të ngjashme duke i vendosur ato në mjete transportuese si konvejerë apo tuba shkarkimi etj;
- d) Lidhin tubat midis gypave kryesore të instalimit në breg të cisternave, depozitave dhe anije të tjera për të ngarkuar dhe shkarkuar naftë, gaze të lëngshëm dhe lëngje të tjera;
- e) Transportojnë dhe bëjnë stivë mallra në depo dhe ndërtesa të ngjashme; f) Ndajnë dhe klasifikojnë ngarkesa para ngarkimit dhe shkarkimit;
- g) Kryejnë punë të tjera të ngjashme si këto;
- h) Zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;
- i) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës.

Kërkesat për punësim

Nuk kërkohet ndonjë kualifikim formal; trajnimi dhe eksperiencia merren gjatë punës. a. Nëse ngarkoni e shkarkoni mallra e bagazhe prej avionëve atëherë duhet të merrni trajnime të veçanta, posaçërisht të lidhura me këtë profesion. b. Duhet pasur shikueshmëri dhe dëgjim shumë i mirë. Informacion shtesë Individidi mund të punësohet në kompani transporti për mallra ndërtimi me kamionë me anije apo me tren. Ata që mund të punësohen në industrinë e transportit me avionë duhet të marrin dëshmi apo garanci për figurë të pastër të personit. Gjithashtu një treg i mirë i punësimeve në këtë profesion janë kompanitë e riciklimit të mbetjeve, magazinat dhe tregjet e mëdha ushqimore, si edhe frigoriferët e mëdhenj të cilët ruajnë mallra në temperatura të caktuara për një kohë të gjatë. Pas fillimit të punës mund të merret eksperiencë e mirë për të ecur në karrierë si përgjegjës i brigadës së punëtorëve të ngarkim shkarkimit.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 9333.01 Punëtor ngarkim-shkarkimi mbetjesh urbane
- 9333.02 Punëtor ngarkim-shkarkimi për materiale ndërtimi
- 9333.03 Punëtor ngarkim-shkarkimi
- 9333.04 Punëtorë ngarkim-shkarkimi mallrash
- 9333.05 Punëtor ngarkim-shkarkimi mobiliesh
- 9333.06 Punëtor ngarkim-shkarkimi në anije
- 9333.07 Punëtor ngarkim-shkarkimi në avion
- 9333.08 Punëtor ngarkim-shkarkimi në kamionë
- 9333.09 Punëtor ngarkim-shkarkimi në pajisjet frigoriferike

9333.10 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tregun ushqimor

9333.11 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tren

Argumentim i numrit të punonjesve:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kimist	1
2	Stilist/Modelist këpucësh	1
3	Përgjegjes prodhimi/drejtues linje	2
4	Prestar lëkure/teknik prerarie	2
5	Punonjes për montimin e kepuceve	2
6	Punonjës makinerish qepjen e kepuceve	30
7	Punonjës paketimi	2
8	Punonjës për llustimi/lyerje të këpucëve	2
9	Shofer	1
10	Punonjes për shpërndarjen	2

1. **Kimist (1)** – Ky specialist është thelbësor për përzgjedhjen dhe testimin e materialeve kimike të përdorura në procesin e prodhimit të lëkurës, ngjyrave dhe ngjitësve, duke siguruar cilësi dhe përputhje me standardet.
2. **Stilist/Modelist këpucësh (1)** – Krijimi i dizajneve dhe modele të këpucëve kërkon një stilist/modelist për të siguruar që produktet janë funksionale, estetike dhe përmbushin kërkesat e tregut.
3. **Përgjegjës prodhimi/Drejtues linje (2)** – Organizimi i linjës së prodhimit kërkon dy drejtues për të mbikëqyrur procesin, optimizuar produktivitetin dhe siguruar që çdo fazë e prodhimit të ndjekë standardet.
4. **Prerës lëkure/Teknik prerarie (2)** – Procesi i prerjes së lëkurës dhe materialeve të tjera është një hap kritik në prodhimin e këpucëve. Dy specialistë sigurojnë që materialet të përpunohen saktësisht për të optimizuar përdorimin dhe të minimizojnë mbetjet.
5. **Punonjës për montimin e këpucëve (2)** – Këta punonjës janë të nevojshëm për bashkimin e pjesëve të këpucëve, duke siguruar që montimi të bëhet saktë dhe në përputhje me specifikimet e modelit.
6. **Punonjës makinerish qepjen e këpucëve (30)** – Qepja e këpucëve është një nga proceset më voluminoze dhe delikate, që kërkon një numër të madh punonjësish për të garantuar cilësi dhe prodhim në sasi të larta.
7. **Punonjës paketimi (2)** – Pas përfundimit të prodhimit, këpucët duhet të paketojnë në mënyrë të rregullt dhe të mbrohen nga dëmtimet. Dy punonjës do të sigurojnë që procesi i paketimit të bëhet me efikasitet.
8. **Punonjës për llustim/lyerje të këpucëve (2)** – Këpucët kalojnë në fazën e fundit të llustimit dhe lyerjes për të arritur pamjen e dëshiruar. Dy specialistë sigurojnë cilësi të lartë në këtë proces.
9. **Shofer (1)** – Transporti i produkteve të përfunduara kërkon një shofer, i cili do të jetë përgjegjës për shpërndarjen e tyre, në përputhje me termat e references së përcaktuara nga AK përfitues i këtij objekti, në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me qendër në Tufinë dhe në Vaqarr. Në raste të ndryshimit të vendit të magazinimit operatori fitues do të njoftohet zyrtarisht.

10. Punonjës për shpërndarjen (2) – Përveç shoferit, dy punonjës janë të nevojshëm për të ndihmuar në ngarkim, shkarkim dhe shpërndarjen e produkteve, duke garantuar që porositë mbërrin në kohë dhe pa dëmtime.

Ky planifikim siguron një proces efikas prodhimi dhe shpërndarjeje, duke optimizuar burimet njerëzore për çdo fazë të punës.

4. Operatori ekonomik duhet të disponojë makinerite si më poshtë:

-makineri prerje automatike - minimalisht 1 copë
-makina qepëse – minimalisht 30 copë
-makineri injektimi dhe montimi (montimi i pjesës së sipërme me pjesën e poshtme të këpucës)- minimalisht 1 copë

Për makineritë dhe pajisjet e deklaruara sipas kësaj pikë të provohet disponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi si më poshtë:

- fatura shit - blerje **ose**
- kontrata shit - blerje **ose**
- kontratë qeraje **ose**
- kontratë huapërdorje.

Shënim: Kriteri nr.4 konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 10. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:.... ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në

dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

- Makineri prerje automatike është një teknologji e avancuar që përdoret për prerjen e materialeve në industrinë e këpucëve, tekstilit dhe sektorë të tjerë të përpunimit të materialeve. Këto makineri funksionojnë me një sistem të kontrolluar dhe sigurojnë prerje precize, të shpejtë dhe me humbje minimale të materialit.

- Makineria për prerje automatike është një pajisje industriale e përdorur në rrobaqepësi për të prerë me saktësi dhe shpejtësi materialet tekstile apo të lëkurës sipas modeleve dhe përmasave të dëshiruara. Kjo teknologji është veçanërisht e rëndësishme në prodhimin e uniformave ushtarake dhe policore, të artikujve këpucë, ku për arsye të specifikimeve teknike të ndërtimit të tyre kërkohet precizion, efikasitet dhe një cilësi e lartë e prerjes. Burimet njerëzore janë të nevojshme dhe të domosdoshme në disa faza të caktuara të prodhimit. Në këtë kuptim njësia e prokurimit konsideron faktin që edhe pse produkti final mund të jetë njësoj përsa i përket cilësisë, një operatori ekonomik që konkuron me deklarinimin dhe paraqitjen e një makinerie të tillë gjysëm automatike do t'i duhej më shumë kohë për realizimin e këtij procesi dhe rrjedhimisht ekziston një risk potencial në zbatimin e kontratës. Pra, kërkesa për një makineri të tillë automatike lidhet me një proces prodhimi komplet automatik dhe më të shpejtë fakt ky i lidhur ngushtësisht edhe me afatin total të zbatimit të kontratës dhe lëvrimit të mallit. Koha/afati është një komponent i rëndësishëm i procesit të prokurimit krahas komponentit çmim dhe cilësi dhe kriteret kualifikuese lidhen ngushtësisht me këto tre komponentë.

- Makineria qepëse është një pajisje thelbësore në industrinë e rrobaqepësisë dhe përdoret për të bashkuar, qepur dhe përforcuar pjesët e materialeve të lekures. Në prodhimin e uniformave ushtarake dhe policore, të artikujve këpucë, makineritë qepëse duhet të jenë të fuqishme, të sakta dhe të përshtatshme për materiale të ndryshme, duke përfshirë edhe lekuren me trashësi të ndryshme.

-Makineri injektimi dhe montimi (montimi i pjesës së sipërme me pjesën e poshtme të këpucës)- përdoret për futjen e kallupit të produktit në këto rast të kepuces që do të prodhohet, në të cilin behet lyerja me mastik dhe injektimi i shollave të kepuces.

Makineritë janë vendosur në propocion me disa elementë sic janë fondi limit, natyra e mallit që prokurohet, specifikimet teknike dhe proceset e punës që kërkohen të realizohen nëpërmjet makinërive automatike dhe numri i punonjësve që do të përfshihen në këtë proces.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- a) ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- b) ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- c) ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

- d) ISO 28001 “Për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- e) ISO 22301 “Për sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

ISO 28001 është një standard ndërkombëtar që lidhet me menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit dhe ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në sigurinë e zinxhirit të furnizimit. Ky standard është i rëndësishëm kur bëhet fjalë për të siguruar që procese të tilla si blerja e uniformave të realizohen në një mënyrë të sigurt dhe efektive, duke përfshirë aspekte të tilla si mbrojtja nga rreziqet në zinxhirin e furnizimit.

Në një procedurë prokurimi për blerje uniformash, implementimi i ISO 28001 mund të jetë i nevojshëm për disa arsye:

- e) Siguria dhe Cilësia e Produkteve: Me këtë standard, siguroheni që furnizuesit dhe distributorët e uniformave respektojnë kriteret e sigurisë dhe cilësisë, duke minimizuar mundësinë e problematikave si produktet e substandardëve që mund të dëmtojnë reputacionin ose sigurinë e punonjësve.
- f) Mbrojtja nga Rreziqet në Zinxhirin e Furnizimit: ISO 28001 ofron një qasje të strukturuar për menaxhimin e rreziqeve që mund të shfaqen gjatë furnizimit të uniformave, si vonesa, cilësi të dobët, ose probleme me logjistikën që mund të ndikojnë në funksionimin e normalizuar të organizatës.
- g) Përmbushja e Rregullave dhe Standardeve Ligjore: Nëse kompania ose organizata juaj vepron në një sektor ku kërkohen standarde të sigurisë (si në industrinë e shëndetësisë, ushtrinë, ose kompani të tjera me kërkesa specifike), përdorimi i ISO 28001 mund të ndihmojë për të siguruar që çdo procedurë e prokurimit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare.
- h) Siguria e Informacionit dhe Trajnimi: Ky standard ndihmon gjithashtu në mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit që mund të lidhen me proceset e furnizimit dhe prokurimit, përfshirë informacionet sensitive që mund të lidhen me uniformat e furnizuara dhe dërgesat.

Nëse është e mundur, ky standard mund të jetë i dobishëm për të siguruar një proces prokurimi transparent dhe të besueshëm, që maksimizon mundësitë për të marrë produkte të cilësisë së lartë dhe të sigurtë.

ISO 22301 është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit (Business Continuity Management System – BCMS), që ofron udhëzime për zhvillimin, implementimin dhe mbajtjen e një plani të efektshëm për të siguruar që një organizatë mund të vazhdojë funksionimin e saj edhe në kushte krize ose pas ndodhisë së një ngjarje të papritur. Ky standard është i rëndësishëm për të siguruar që organizata mund të mbajë një nivel të lartë të shërbimeve dhe produkteve të saj, edhe në situata emergjente.

Në kontekstin e një procedure për blerjen e uniformave, përdorimi i ISO 22301 është i rëndësishëm për disa arsye kryesore:

1. Sigurimi i Vazhdueshmërisë së Furnizimit

- Nëse një organizatë ka një plan prokurimi për uniforma, ndodhin shpesh situata ku furnizuesit mund të kenë vonesa, probleme të prodhimit ose mungesë të lëndëve të para. Nëse është e mundur, një sistem i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit do të mundësojë që organizata të ketë mekanizma të gatshëm për të siguruar furnizim të pandërprerë, madje edhe në rast të problemeve të papritura.
- ISO 22301 ndihmon në identifikimin dhe minimizimin e rreziqeve që mund të dëmtojnë zinxhirin e furnizimit, duke siguruar që, nëse ka probleme me furnizuesit ekzistues, të ketë opsione alternative për të siguruar uniformat e nevojshme.

2. Rëndësia e Planifikimit për Situata Emergjente

- Në rast të krizave të papritura (p.sh., fatkeqësi natyrore, ndërprerje të furnizimeve, ose probleme me transportin), një sistem i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit mund të ndihmojë për të siguruar që blerja e uniformave të vazhdojë pa probleme, duke minimizuar ndalimet në operacionet e përditshme.
- ISO 22301 ndihmon në krijimin e një plani të qartë dhe të strukturuar për të menaxhuar situatat emergjente që mund të ndikojnë në procesin e blerjes, si për shembull ndalesa të paplanifikuara të prodhimit nga furnizuesit, apo problemet me shpërndarjen.

3. Menaxhimi i Rreziqeve të Furnizuesve

- Ky standard gjithashtu ndihmon për të siguruar që organizata të ketë një sistem për të menaxhuar rreziqet që mund të vijnë nga furnizuesit e uniformave, si dhe për të vlerësuar vazhdimisht performancën e tyre. Nëse një furnizues nuk mund të plotësojë kërkesat për shkak të një krize ose ngjarjeje, ISO 22301 ndihmon në sigurimin e alternativeve, të cilat mund të ndihmojnë për të mbajtur vazhdimësinë e furnizimeve.

4. Përmirësimi i Besueshmërisë dhe Reputacionit të Organizates

- Implementimi i ISO 22301 mund të ndihmojë për të rritur besueshmërinë e një organizate për klientët dhe partnerët e saj. Kur një kompani tregon që ka një sistem të menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit, ajo tregon angazhimin për të garantuar që operacionet e saj nuk do të ndalojnë, pavarësisht nga situatat e jashtme.
- Për blerjen e uniformave, kjo do të thotë që do të mund të siguroheni që ndonëse mund të ketë çështje të jashtme që prekin zinxhirin e furnizimit, organizata juaj mund të vazhdojë të ofrojë produkte dhe shërbime pa ndërprerje.

5. Përgatitja dhe Trajnimi i Personelit

- ISO 22301 përfshin gjithashtu trajnimin dhe përgatitjen e personelit për të reaguar në mënyrë të shpejtë dhe efektive në situata emergjente. Ky është një faktor i rëndësishëm në menaxhimin e procedurave të prokurimit, duke siguruar që në rast emergjence, stafi i përfshirë në prokurimin e uniformave mund të veprojë shpejt dhe me efikasitet.

Përfundim:

Përdorimi i ISO 22301 në procedurën për blerjen e uniformave është i rëndësishëm për të siguruar që proceset e furnizimit të mos ndërpriten dhe që çdo krizë ose ngjarje e papritur të menaxhohet në mënyrë efektive. Kjo do të sigurojë që organizata të mund të vazhdojë funksionimin e saj pa ndërprerje, duke ruajtur reputacionin dhe besueshmërinë e saj në treg.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Çertifikatën OEKO-TEX për lëkurën (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, për të vertetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kane substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX për lëkurën ose ekuivalente. Në mungesë të certifikimit OEKO-TEX për lëkurën ose ekuivalente, do të pranohen raportet e testimi të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë

akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX për lëkurën.

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 e 3 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.... 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.”* Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Referuar specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, Njësia e Prokurimit gjykon se është e domosdoshme paraqitja e certifikatës OEKO-TEX për lëkurën (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, pasi është standarti që përfshin artikujt që kanë kontakt direkt me lëkurën dhe është në përputhshmëri me rregulloren e Bashkimit Europian që synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të kimikateve (Registration, Evaluation, Authorization and Restriction of Chemicals –REACH), duke përfshirë kufizimet për substanca të caktuara të rrezikshme. Ky standart certifikon produktet, pasi janë të testuara për substanca të dëmshme duke siguruar që të jenë të sigurta dhe të mbrojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga kimikatet toksike.

Cdo komponent i një produkti që nga lënda e parë e deri te produkti final, duhet të jenë testuar rigorozisht kundër shumë kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

OEKO-TEX për lëkurën (ose ekuivalente) është një nga etiketat më të njohura në botë për lëkurën e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit.

Nëse një artikull këtë etiketë, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

Me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes në zbatim të LPP më sipër cituar, është lënë mundësia që përveç certifikimeve të kërkuara, operatorët ekonomikë të paraqesin edhe dokumenta të tjera të pranohen raportet e testimit nga laboratorë të akredituar të cilat vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca

të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX për lëkurën.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) mostrat e artikujve sipas tabelës;
- b) mostrat e lëndës së parë sipas tabelës;
- c) skedat teknike sipas tabelës
- ç) fletë analizë laboratorike të lëndës së parë sipas tabelës, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

të cilat vërtetojnë se artikujt e ofruar janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit

-Skedat teknike dhe fletë analizë laboratorike të lëndës së parë, sipas kërkesave në tabelën e mëposhtme, do të paraqiten nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Mostrat e artikujve, lëndës së parë dhe fletë analizat që do të paraqiten për artikujt si më poshtë:

	Lista e artikujve mostër	Njësia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
1	Këpucë pune Meshkuj.	palë	Nje pjesë të lëkurës së jashtme të përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Skedat teknike të lëkurës duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
2	Këpucë pune Femra.	palë	Nje pjesë të lëkurës së jashtme të përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Skedat teknike të lëkurës duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
3	Këpucë gjysëm qafa M/F.	palë	Nje pjesë të lëkurës së jashtme të përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Skedat teknike të lëkurës duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
4	Këpucë taktike vere dimri (Goretex) M/F.	palë	Nje pjesë të lëkurës së jashtme të përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Skedat teknike të lëkurës duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
5	Këpucë dimri me qafa M/F.	palë	Nje pjesë të lëkurës së jashtme të përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Skedat teknike të lëkurës duhet të shoqërohen me Fletë analiza/Raporte testimi nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.

Mënyra e dorëzimit të mostrave:

Secili prej artikujve të sipërcituar, duhet të dorëzohet në një kampion / moster i cili duhet të jetë i qepur me fije me ngjyrë të kuqe. Artikujt duhet të kenë të qepur / montuar të gjithë aksesoret, sipas specifikimeve teknike. Kampionet / mostrat duhet të kenë të qepur/ngjitur etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar dhe të jenë me ambalazhim fabrike.

Kampionet / mostrat duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme me numrin rendor përkatës, të fiksuar në artikull dhe të vulosur nga ofertuesi, sipas numrit rendor të tabelave të mësipërme.

Masat e mostrave të kërkuara si më sipër të jenë për femra numri 40 dhe për meshkuj 45, janë vendosur të tilla me qëllim trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurën e mësipërme. Në rastet kur artikujt e kërkuar për mostër janë për të dy gjinitë (femra/meshkuj) do të paraqitet masa 45.

Mos dorëzimi i kampioneve / mostrave sipas kërkesave të sipër përmendura përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e mostrave dhe skedat teknike si më sipër është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi dhe të lëndës së parë, të përcaktuara si më sipër, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, llojin e mallit që kërkohet, specifikimet teknike të artikujve dhe aksesoreve që ato përmbajnë, të cilat janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi “Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë

së materialit të produktit final, dizenjimin e uniformave, dimensionet e kërkuara, si dhe karakteristika të tjera që lidhen me aksesoret që kanë këto artikuj, të cilat nuk mund të verifikohen përmes dokumentave të tjerë të kërkuara. Përfshirja e mostrave rrit transparencën dhe objektivitetin, duke i dhënë komisionit të vlerësimit një bazë të qartë për të krahasuar ofertat dhe për të marrë një vendim të drejtë. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Kërkesa e për paraqitjen e fletë analizave të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues”, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2028 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës), nëpërmjet të cilave duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e artikujve që ata ofrojnë me specifikimet teknike të objektit të prokurimit sipas specifikimeve teknike të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi “Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, çka tregon për rëndësinë që ka uniforma e Policisë së Burgjeve për ruajtjen e rendit publik në sistemin penitenciar të Republikës së Shqipërisë.

Ky kriter është vendosur, gjithashtu duke iu referuar specifikimeve teknike ku verifikimi i disa elementeve të cilësisë së artikujve mund të verifikohet vetëm nëpërmjet analizave laboratorike për sa i përket lëndës së parë të përdorur për realizimin e produktit final. Fleta e analizës laboratorike garanton që materialet e përdorura për prodhimin e artikujve veshmbathje i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, ku përfshihen lloji i lëndës së parë të përdorur dhe përbërësve të tjerë ndaj forcave mekanike, ujit, kimikateve apo faktorëve të tjerë që ndikojnë në performancën e produktit final. Fletë analizat sigurojnë që produkti përfundimtar do të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim afatgjatë. Siguria e përdoruesve të produktit përfundimtar, është një tjetër faktor që e bën të domosdoshme kërkesën për analiza laboratorike, duke i garantuar ata që produkti është i sigurt dhe mund të ofrojë mbrojtje adekuate daj rreziqeve të caktuara.

Në këtë kriter është kërkuar që mostra duhet të jetë i qepur me fije me ngjyrë të kuqe me qëllim që artikujt objekt prokurimi të jenë prodhuar enkas për këtë procedurë prokurimi dhe për një trajtim të barabartë për të gjitha operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit/(per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerese, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.8 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 10. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Referuar shtojcës 7 janë përcaktuar termat e referencës në lidhje me zbatimin e kontratës, ku është përcaktuar se Artikujt e Uniformës dhe të Këpucëve të Policisë së Burgjeve do të magazinohen në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me qendër në Tufinë dhe në Vaqarr. Në raste të ndryshimit të vendit të magazinimit operatori fitues do të njoftohet zyrtarisht, duke i dhënë mundësi operatorit ekonomik të organizohet për të furnizuar artikujt objekt kontrate në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor përfitues.

Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për minimumi 1 mjet është vendosur duke patur në konsideratë vendin e dorëzimit të objektit të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht me e favorshme.

Shënim: Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim: Bazuar në nenin 82 pika 4 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

Shënim: Bazuar në nenin 14 pika 2 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorezohen vetëm nga operatori ekonomik që është shpallur fitues:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimeve teknike për artikujt objekt prokurimi, pët të dy lotet, janë miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi "Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve", të ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr. 260 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve", i ndryshuar, për autoritetin kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Specifikimet Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkelidhur DST

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimet teknike për artikujt objekt prokurimi, për të dy lotet, janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 296 datë 19.05.2021 mbi “Përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin Nr. 260 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, i ndryshuar.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: (Kërkesat vijuese të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë hartuar nga autoriteti kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve)

- **Grafiku i lëvrimit.**

Artikujt e Uniformës dhe të Këpucëve të Policisë së Burgjeve do të magazinohen në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me qendër në Tufinë dhe në Vaqarr.

Në raste të ndryshimit të vendit të magazinimit operatori fitues do të njoftohet zyrtarisht.

Afati i lëvrimit të jetë 120 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Gjatë procesit të punës për realizimin e artikujve të uniformës DPB-ja mund të bëjë ndryshime të mundshme të elementeve të veçanta të saj dhe shenjave dalluese etj., sipas ndryshimeve të strukturës e perspektivës së policisë së Burgjeve pa prekur në tërësi thelbin e tyre dhe brenda vlerës së fondit.

- Masat trupore të punonjësve të Policisë së Burgjeve për artikujt e Uniformës dhe të Këpucëve do të evidentohen nga Operatori Ekonomik i zgjedhur fitues i cili ka përgjegjësinë për krijimin e bazës së të dhënave të masave trupore të punonjësve të policisë së Burgjeve. Periudha e marrjes së masave trupore të jetë para afatit 120 ditë të lidhjes së kontratës.
- Artikujt e Uniformës të jenë “SET” për secilin punonjës. SET-i të përmbajë të gjitha elementet e Uniformës sipas përmasave trupore, pozicionit dhe gradës.
- Firmat pjesëmarrëse duhet të paraqiten në tender me mostrën e çdo artikulli të uniformës së policisë së burgjeve të cilët duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e AK me të cilën do të krahasohet produkti përfundimtar.
- Kontraktuesi duhet ta shoqërojë mallin me Fletë analizë laboratorike origjinale të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë dhe ndihmëse nga një organ i specializuar, në përputhje me specifikimet teknike.
- Afati garancisë (sipas tabelës së mëposhtme do të jetë 1 vit për artikujt që e kanë afatin e përdorimit 1 vit dhe të paktën 2 vjet për artikujt që kanë afatin e përdorimit 2 vjet. Në rastet kur artikulli pëson defekt si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike, operatori ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvëndësimin e plotë të artikullit, pa pagesë konform specifikimeve teknike.

Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet detyrimisht me deklaratën e garancisë e cila fillon në momentin e kolaudimit.

Nr.	Artikujt që duhet të plotësojnë garancinë 1 vit	Artikujt që duhet të plotësojnë garancinë 2 vjet
1	Këpucë pune Meshkuj.	Kostum i Uniformës së punës për Meshkuj: 1 Xhaketë pune me komça me shqiponjë, 2 pantallona, kapele meshkuj.
2	Këpucë pune Femra.	Kostum i Uniformës së punës për Femra: 1 Xhaketë pune me komça me shqiponjë, 1 pantallona, 1 fund, kapele femra.
3	Këpucë gjysëm qafa M/F.	Bluzë polo mëngë të shkurtra M/F.
4	Këpucë taktike vere dimri (Goretex) M/F.	Pulovër me jakë “V” blu e errët M/F.
5	Këpucë dimri me qafa M/F.	Xhuboks (Xhaketon) blu e errët M/F.

6	Pantallona vere M/F.	Pelerinë shiu (Poncho).
7	Pantallona dimërore M/F.	Rrip multifunksional.
8	Këmishë me mëngë të gjata M/F.	Rrip pantollonash lëkure.
9	Këmishë me mëngë të shkurtra M/F.	Doreza lekure te zeza.
10	Gradat e mëdha supi.	Xhup dimri blu e errët/e zezë.
11	Gradat e vogla gjoksi.	Kostum stërvitje RIP-STOP për Policinë e Burgjeve blu e errët, xhaketa, pantallona, kapele sportive.
12	Shenja e identifikimit.	Kostum RIP-STOP për forcat speciale ngjyrë e zezë, xhaketë, pantallona, kapele sportive.
13	Kravata.	Kapuç maskimi .
14	Çorape të shkurtra.	Dorreza Luftimi.
15	Çorape të gjata.	Jelek operacional.
16	Shenjë krahut Policia e Burgjeve, Stema e Republikës	Veshje e brendshme e zezë bluzë dhe tutë e zezë.
17	Shenjë krahut Policia e Burgjeve, Stema e Policisë së Burgjeve.	
18	Bluza me mëngë të shkurtra blu e errët/e zezë.	.
19	Bluza me mëngë të shkurtra Polo blu e errët/e zezë.	
20	Bluza me mëngë të gjata termike blu e errët/e zezë.	
21	Pulovër me jakë golf mëngë të gjata.	
22	Shenjë krahut Policia e Burgjeve, Forcat Speciale.	

NJËSIA E PROKURIMIT